



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 29 regjistër (JR)

Datë 05.11.2018

Nr. 21 i vendimit

Datë 13.09.2019

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Luan Daci</b>	<b>Relator</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- mori në shqyrtim më datë 13.09.2019, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Hans Kijlstra, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), mori në shqyrtim ankimin e Komisionerit Publik Florian Ballhysa, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dhe kundërankimin e subjektit të rivlerësimit Gentian Medja, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dhe dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Luan Daci, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Z. Gentian Medja është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë (në vijim “GjAShP”) Tiranë, sipas përcaktimit të nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit është përfshirë në listën e subjekteve të cilët janë vlerësuar me përparësi, për shkak të qenies anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas përcaktimit të nenit 284, pika 9 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

1.1. Në vijim të dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit – *vetting* (në vijim “deklarata *vetting*”) në datën 27.01.2017, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), me anë të shkresës nr. {\*\*\*}, datë 13.11.2017, ka përgatitur raportin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe ka arritur në përfundimet se:

- a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- b) subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe
- d) subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

1.2. Në vijim të dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit të deklaratës për kontrollin e figurës në datën 26.01.2017, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka përgatitur raportin mbi kontrollin e figurës me anë të shkresës nr. {\*\*\*}, datë 27.10.2017, duke arritur në përfundimet se:

- a) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016;
- b) subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës;
- c) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar; dhe
- ç) konstatohet se është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

1.3. Në vijim të dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional në datën 26.01.2017, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka përgatitur raportin për analizimin e aftësive profesionale me anë të shkresës nr. {\*\*\*}, datë 23.4.2018, bazuar në dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe me anë të shkresës nr. {\*\*\*}, datë 15.02.2018, ka përgatitur raportin

edhe për 5 (pesë) dokumente të tjera ligjore, sipas kërkesës së Komisionit, të përzgjedhura po në mënyrë objektive dhe rastësore.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 60, datë 01.08.2018, ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Medja, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, duke arritur në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit:
  - i) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë (neni 59, germa “a” e ligjit nr. 84/2016);
  - ii) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës (neni 59, germa “b” e ligjit nr. 84/2016);
  - iii) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 59, germa “c” e ligjit nr. 84/2016).

## **III. Shkaqet e ankimit dhe të kundërankimit**

3. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim “ONM”), sipas përcaktimit të nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet 3 (tre) prej vëzhguesve ndërkombëtarë, i ka paraqitur rekomandim me shkrim Komisionerit Publik, duke identifikuar gjetje dhe mangësi në lidhje me çështjet e marra në vlerësim nga Komisioni për kriterin e aftësive profesionale, në vijim të të cilit paraqiti ankim Komisioneri Publik vetëm për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, në të cilin kërkonte që, pasi të ketë kryer vetë Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), një hetim në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, mbështetur në metodologjinë e paraqitur në ankim, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:
  - i) ndryshimin<sup>1</sup> e vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ose
  - ii) lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**3.1.** Komisioneri Publik, në shkaqet ankimore të paraqitura, duke iu referuar rekomandimit të datës 09.08.2018 dhe rekomandimit shtesë të datës 13.09.2018 të ONM-së, parashtron se ankimi i vendimit, duke analizuar secilën prej 13 (trembëdhjetë) çështjeve të marra në shqyrtim gjatë procesit të rivlerësimit të zhvilluar nga ana e Komisionit, do të mundësojë që Kolegji:

a) të vendosë nëse rezultati i vlerësimit të aftësisë profesionale në rastin konkret është i justifikuar;

---

<sup>1</sup> Në parashtrimet përfundimtare të datës 09.09.2019, Komisioneri Publik kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Medja, duke e arsyetuar Kolegji në vendimin e tij dhe orientimin që duhet të ketë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mbi mënyrën e rivlerësimit të aftësisë profesionale, bazuar jo vetëm në raportet e hartuara nga organet ndihmëse të këtij procesi, por duke u bazuar edhe në këtë metodologji konkrete, në plotësim dhe të gjithë indikatorëve dhe nënindikatorëve ligjorë, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, ashtu sikurse u trajtua edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje.

b) të sqarojë disa çështje ligjore të konstatuara nga çështjet e vëzhguara, në lidhje me ligjin e zbatueshëm, respektimin e afateve ligjore, dokumentimin në akt të veçantë të urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme; dhe

c) të ofrojë disa udhëzime të përgjithshme mbi qasjen dhe metodologjinë e vlerësimit të aftësive profesionale.

4. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar kundërankim, duke kërkuar: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.
5. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka kaluar nivelin e besueshmërisë për kriteret e pasurisë dhe të figurës, por pretendon se vendimi i Komisionit është i cenueshëm në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, pasi Komisioni nuk ka arritur të evidentojë, kategorizojë dhe të vlerësojë siç duhet një sërë gjetjesh, që lidhen me mangësi të konsiderueshme të aftësive profesionale të shfaqura gjatë ushtrimit të funksionit.
6. Procedura e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas Komisionerit Publik, nuk mund të konsiderohet thjesht në nivelin konstatues dhe certifikues të gjetjeve të organeve të tjera ndihmëse, që mbështesin institucionet e rivlerësimit, sikundër janë Inspektorati apo struktura e posaçme pranë Prokurorisë së Përgjithshme, dhe çmon se veçanërisht për të garantuar efikasitetin e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, në mënyrë profesionale dhe transparente, brenda kufijve të vendosur me ligj, është e domosdoshme që institucionet e rivlerësimit të përdorin një metodologji të qartë, e cila përfshin dhe bën pjesë të saj edhe vlerësimin e Inspektoratit, por nuk mbetet e varur prej tij. Qasja e Komisionit se kriteri i vlerësimit të aftësive profesionale është i varur nga ekzistenca e gjetjeve në vlerësimin e pasurisë dhe atë të kontrollit të figurës nuk është shprehje e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, pasi vlerësimi i aftësive profesionale, vlerësimi i pasurisë dhe vlerësimi i kontrollit të figurës, po aq sa janë të ndërlidhur, qëndrojnë të pavarur gjatë kryerjes së procedurave dhe arritjes së përfundimeve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.
7. Në ankim, Komisioneri Publik, pasi i ka analizuar nominalisht 3 (tri) vendimet e përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 10 (dhjetë) çështjet e zgjedhura me short, sipas specifikave të çështjeve konkrete, ka pretenduar për shkelje ligjore të natyrës procedurale.

7.1. Komisioneri Publik ka pretenduar se çështjet janë vënë në lëvizje, janë kryer veprimet përgatitore dhe janë zhvilluar seancat përgatitore dhe ato gjyqësore jashtë afateve ligjore, si dhe se çështjet janë gjykuar tej afatit të arsyeshëm.

7.2. Është konstatuar, sipas Komisionerit Publik, mungesë e akteve procedurale, njoftimeve për thirrjen e palëve, urdhrave, vendimeve të ndërmjetme apo procesverbaleve të seancave, gjatë veprimeve përgatitore, seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore.

7.3. Sipas Komisionerit Publik, ka mospërputhje midis pjesës hyrëse dhe asaj arsyetuese të vendimit gjyqësor të dhënë prej subjektit të rivlerësimit, referenca të gabuara ligjore dhe mosreferim si bazë ligjore të ligjit të posaçëm *lex specialis*, në disa raste vendimet nuk përmbajnë

pretendimet përfundimtare dhe në dispozitivin e vendimit është përcaktuar afat 5-ditor ankimi, ndërkohë që afati i ankimit është 15 ditë.

**7.4.** Komisioneri Publik kundërshton arsyetimin e Komisionit, duke parashtruar se mangësitë e konstatuara në 13 (trembëdhjetë) çështjet e gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit i ka vlerësuar duke u bazuar në mënyrë të përgjithshme në nenet 72-74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”). Sipas Komisionerit Publik, Komisioni ka pranuar të gjitha pretendimet e subjektit rreth mangësive të gjetura, duke vlerësuar se për nenet 75 dhe 76 të ligjit nuk kanë rezultuar të dhëna negative, dhe ka arritur në vlerësimin se subjekti i rivlerësimit duhet të vlerësohet si “i aftë”, por Komisioni nuk ka marrë parasysh që secili kriter ka indikatorë specifikë matës, dhe për këtë arsye për Komisionerin Publik ky model vlerësimi nuk është i përshtatshëm, ai paraqitet i përgjithshëm dhe me shumë elemente subjektive në përmbajtjen e tij.

**7.5.** Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankimin nr. {\*\*\*} prot., datë 12.10.2018, kundër vendimit nr. 7, datë 01.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me anë të cilit ishte vendosur mospranimi i kundërankimit nr. {\*\*\*} prot., datë 26.09.2018, i paraqitur nga ky i fundit kundër ankimit të Komisionerit Publik. Subjekti i rivlerësimit parashtrroi si shkaqe se është njoftuar me vendimin e mospranimit të ankimit në datën 20.09.2018, dhe se kundërankimi është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar brenda afatit 5-ditor<sup>2</sup>, në datën 24.09.2018. Trupi gjykues i Kolegjit, me vendimin e datës 17.06.2019, vendosi të pranojë ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, duke e ndryshuar vendimin nr. 7, datë 01.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe pranimin për shqyrtim të kundërankimit, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Gentian Medja. Subjekti i rivlerësimit i ka kundërshtuar në kundërankim pretendimet e ngritura nga Komisioneri Publik për shkelje ligjore, duke theksuar se nuk janë cenuar të drejtat e palëve në gjykim.

**7.6.** Në lidhje me pretendimin për mosrespektimin e afateve ligjore, subjekti i rivlerësimit pretendon se çështjet janë gjykuar brenda afatit të arsyeshëm prej 1 (një) viti, ndërkohë që për ato raste kur nuk është respektuar afati i vënies në lëvizje të çështjeve, kryerjes së veprimeve përgatitore dhe zhvillimit të seancave gjyqësore, ka qenë për shkaqe objektive, të tilla si mbingarkesa me çështjet në gjykim apo mungesa në punë për shkak të trajnimeve në Shkollën e Magjistraturës.

**7.7.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pasaktë pretendimin për mungesë të procesverbaleve në dosje, ndërkohë që për pjesën që u përket njoftimeve, parashtron se në disa

---

<sup>2</sup> Neni 456, paragrafi i parë i K.Pr.Civile, përcakton: “Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankimi, mund ta kundërshtojë atë me kundërankim brenda 5 ditëve nga dita që ka marrë njoftim për ankimin e palës tjetër”. Neni 149 i K.Pr.Civile, përcakton: “Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24 të saj, por kur do të kryhet ndonjë veprim procedural ose do të paraqitet ndonjë kërkesë ose akt tjetër në gjykatë, afati mbaron në çastin e mbarimit të orarit zyrtar. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit”. Neni 49 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. [...]”.

raste ato janë kryer nëpërmjet telefonit nga sekretaria e gjykatës dhe seancat janë zhvilluar rregullisht, ndërkohë që aktet procedurale, si urdhrat, vendimet e ndërmjetme, janë dokumentuar të gjitha në procesverbalet e administruara në dosjet përkatëse gjyqësore.

**7.8.** Në lidhje me pretendimin për mospërputhje të bazës ligjore, për referenca të gabuara ligjore dhe mosreferim në *lex specialis*, subjekti i rivlerësimit e kundërshton me argumentin se gjykata nuk është e detyruar që të mbështetet vetëm në bazën ligjore të parashikuar nga pala paditëse në kërkesëpadi dhe vlerëson se duhet të kihet parasysh edhe parashikimi i nenit 72, paragrafi 4 i ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, duke vijuar se përpilimi i vendimit përfundimtar të gjykatës duke shënuar në pjesën hyrëse të vendimit palët, objektin dhe bazën ligjore, ashtu siç i ka pretenduar pala paditëse në kërkesëpadinë e saj, duke theksuar se është një standard i zbatuar në të gjithë sistemin gjyqësor shqiptar dhe se ndryshimi me iniciativë të gjykatës i bazës ligjore të referuar nga pala paditëse do të përbënte shkelje të parimit të disponibilitetit të padisë dhe parimit të paanësisë së gjykatës.

**7.8.1.** Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik për caktimin e afatit 5-ditor të ankimit dhe jo 15 ditë, subjekti i rivlerësimit parashtron se ka qenë gabim material, ndërkohë që në lidhje me mospërmbajtjen në vendim të pretendimeve përfundimtare, kundërshton se ato janë shënuar në vendim.

- 8.** Gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues i Kolegjit, në përgjigje të shkaqeve të ankimit dhe kërkesës për hetim të Komisionerit Publik, kërkoi nga institucionet përkatëse dhe administroi në dosjen gjyqësore:
- i) dosjen personale të magjistratit, z. Gentian Medja;
  - ii) mendimin e kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë;
  - iii) informacionin me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës.
- 9.** Krahas këtyre akteve, subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të Kolegjit të administrojë edhe disa akte të reja të depozituara prej subjektit të rivlerësimit, specifikisht:
- i) axhendën e seminarit me temë “Bashkëpunimi juridik mes vendeve të Ballkanit Perëndimor në fushën civile, tregtare dhe familjare”, si dhe konfirmimin e pjesëmarrjes;
  - ii) vendimin nr. 49, datë 16.10.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Mbi miratimin e dokumenteve për ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit”;
  - iii) vendimin nr. 24, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”.
- 10.** Pas administrimit të provave dhe mbylljes së shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, Komisioneri Publik në kërkimin përfundimtar, në vlerësimin tërësor të të gjitha provave të administruara, i kërkoi trupit gjykues të Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Gentian Medja, si dhe i kërkoi Kolegjit të arsyetojë në

vendimin e tij dhe orientimin që duhet të ketë Komisioni mbi mënyrën e rivlerësimit të aftësisë profesionale, bazuar jo vetëm në raportet e hartuara nga organet ndihmëse të këtij procesi, por duke u bazuar dhe në metodologji konkrete, në plotësim dhe të gjithë indikatorëve dhe nënindikatorëve ligjorë të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), ashtu sikurse u trajtua edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje.

**10.1.** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shqyrtimi gjyqësor nga ana e Kolegjit i ankimit, në referencë të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit C, pika 2, nenit F, pikat 2 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nisur nga fakti se objekti i këtij ankimi ishte në funksion të miratimit dhe të përdorimit të një metodologjie vlerësimi më efektive, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, propozuar dhe në përmbajtjen e rekomandimit prej 3 (tre) vëzhguesve ndërkombëtarë, evidentoi jo vetëm kompleksitetin e çështjes, por edhe disa mangësi të procedurës së vlerësimit të aftësive profesionale dhe materiale në drejtim të plotësimit të indikatorëve dhe nënindikatorëve, referuar burimeve të vlerësimit profesional të magjistratëve, të parashikuara nga ligji nr. 96/2016.

**10.1.1.** Këto mangësi, sipas Komisionerit Publik, u vërejtën në disa burime të kontrollit të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, si: mungesa e dosjes personale të magjistratit, parashikuar nga neni 77, germa “a” e ligjit nr. 96/2016, mungesa e mendimit të Kryetarit të Gjykatës, parashikuar nga neni 77, germa “d” e ligjit nr. 96/2016 dhe mungesa e informacionit me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, parashikuar nga neni 77, germa “e” e ligjit nr. 96/2016.

**10.1.2.** Komisioneri Publik parashtron se në funksion të kërkimit përfundimtar drejtuar juridiksionit kontrollues të Kolegjit, në supozim të miratimit të draft-metodologjisë së paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka realizuar vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke reflektuar gjetjet në 13 (trembëdhjetë) çështjet e trajtuara, bazuar në tregues të matshëm, sipas kërkimit të Komisionerit Publik, të shenjuar me +/- në tabelat për çdo indikator dhe nënindikator vlerësimi, të parashikuar nga ligji nr. 96/2016.

**10.1.3.** Sipas Komisionerit Publik, rezultatet dhe panorama e krijuar nga shenjimi i treguesve të kësaj metodologjie, ku në rastin konkret gjetjet negative (-) të konstatuara, mbizotërojnë në 13 (trembëdhjetë) çështjet që kanë rezultuar nga dokumentet ligjore, në kuptim të nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të trajtuara, kryesisht në zbatimin e parimit të përgjithshëm të teorisë të së drejtës, mbi përdorimin e *lex specialis*, parashikuar nga neni 74/5 i ligjit nr. 96/2016, janë vlerësuar në raport me rezultatet pozitive (+), të rezultuara në vlerësim të indikatorëve të tjerë, marrë dhe nga burimet shtesë të vlerësimit të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe bazuar në rezultatet e draft-metodologjisë, duke i konsideruar ato në një vlerësim tërësor të rrethanave të çështjes në raport me sa është administruar nga aktet në dosje të Komisionit, si dhe në analizë të përmbajtjes së akteve të reja të administruara gjatë hetimit gjyqësor, Komisioneri Publik arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton që me njohuritë, aftësitë në gjykim, qëndrimet e tij paraqet një model pune aq të dobët, sa që rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve dhe, për rrjedhojë,

vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues “i aftë”, në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas kuptimit që i jep këtij niveli, neni 44 i ligjit nr. 84/2016.

**10.1.4.** Komsioneri Publik, bashkëlidhur pretendimeve përfundimtare, ka paraqitur edhe tabelën e metodologjisë, të plotësuar për çdo rubrikë, për çdo kriter vlerësimi.

**10.1.5.** Përfundimet e arritura nga Komsioneri Publik në lidhje me aftësitë profesionale (neni 72 i ligjit nr. 96/2016), duke marrë si burime 3 vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit<sup>3</sup>, 5 çështjet nga shorti i parë<sup>4</sup> dhe 5 çështjet nga shorti i dytë<sup>5</sup>, rezultojnë si më poshtë.

- a) Njohuritë ligjore (neni 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016):
- i) aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjit + (13);
  - ii) aftësia e përgjithshme për të identifikuar konfliktin e normave - (6) / + (7);
  - iii) aftësia për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës - (7) / + (6);
  - iv) aftësia për të analizuar jurisprudencën - (2) / + (11).
- b) Arsyetimi ligjor (neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016):
- i) qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit - (3) / + (10);
  - ii) struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit - (2) / + (11);
  - iii) cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik - (2) / + (11).

**10.1.6.** Përfundimet e arritura nga Komisioneri Publik në lidhje me aftësinë organizative (neni 74 i ligjit nr. 96/2016), duke marrë si burime 3 vendimet e përzgjedhura, 5 çështjet e shortit të parë dhe 5 çështjet e shortit të dytë, rezultojnë si më poshtë.

- a) Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës (neni 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016):
- i) respektimi i afateve ligjore - (8) / + (5);
  - ii) plotësimi i standardeve minimale kohore - (3) / + (10);
  - iii) koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje - (1) / + (12);
  - iv) rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore - (1) / + (12);
  - v) koha mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor - (2) / + (11).
- b) Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore (neni 74, pika 5 e ligjit nr. 96/2016):
- i) rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes - (10) / + (3);
  - ii) saktësia e dokumentacionit të dosjes - (10) / + (3).

<sup>3</sup> {\*\*\*} kundër {\*\*\*}, {\*\*\*} kundër {\*\*\*}, dhe T.M. kundër {\*\*\*}.

<sup>4</sup> F.C. kundër {\*\*\*}, Q.Z. kundër {\*\*\*}, {\*\*\*} kundër {\*\*\*} dhe të tjerë, A.Z. kundër {\*\*\*} dhe të tjerë, {\*\*\*} kundër {\*\*\*} dhe të tjerë.

{\*\*\*} kundër {\*\*\*}, P. N. kundër {\*\*\*}, B. B. kundër {\*\*\*}, E. M. kundër {\*\*\*} Tiranë, A. B. kundër {\*\*\*}.



**10.1.7.** Përfundimet e arritura nga Komisioneri Publik në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale (neni 75 i ligjit nr. 96/2016), duke marrë si burime raportin e KLD-së, mendimin e Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, raportin e ILDKPKI-së dhe denoncimet, rezultojnë si më poshtë.

- a) Etika në punë (neni 75, pika 2 e ligjit nr. 96/2016):
  - i) rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre (+);
  - ii) mendimi i kryetarëve (+);
  - iii) vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit (+).
- b) Integriteti i magjistratit (neni 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016):
  - i) rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre (+ 10);
  - ii) mendimi i kryetarëve (+);
  - iii) vendimet përfundimtare për masat disiplinore (+ 11);
  - iv) raportet e ILDKPKI-së (+).

**10.1.8.** Përfundimet e arritura nga Komisioneri Publik në lidhje me cilësitë personale dhe angazhimin profesional (neni 76 i ligjit nr. 96/2016), duke marrë si burime raportin e KLD-së, mendimin e Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresën e Shkollës së Magjistraturës dhe dosjen personale, rezultojnë si më poshtë.

- a) Aftësia e komunikimit të magjistratit (neni 76, pika 2 e ligjit nr. 96/2016):
  - i) komunikim i qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët (+);
  - ii) respektimi i konfidencialitetit (+);
  - iii) respektimi i parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale (+).
- b) Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët (neni 76, pika 3 e ligjit nr. 96/2016):
  - i) komunikimi dhe bashkëveprimi me kolegët apo administratën gjyqësore (+);
  - ii) shkëmbim i njohurive apo i përvojës profesionale me ta (+).
- c) Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera (neni 76, pika 4 e ligjit nr. 96/2016):
  - i) pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës (+);
  - ii) pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale (+);
  - iii) disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj (+);
  - iv) pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtari të për

marrëdhëniet me publikun të gjykatave (+);  
v) publikimet ligjore akademike (s'ka info.).

11. Pas administrimit të provave dhe mbylljes së shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

11.1. Në lidhje me konstatimin për mosrespektim në mënyrë të përsëritur të afateve në gjykimin e çështjeve, subjekti i rivlerësimit në pretendimet përfundimtare kundërshtoi se në disa raste është i pasaktë, dhe në disa raste ka qenë pasojë e pamundësisë objektive për të gjetur kohën për të zhvilluar seancat përgatitore dhe ato gjyqësore<sup>6</sup>.

11.2. Në lidhje me mospasjen e urdhërave apo vendimeve të ndërmjetme, subjekti i rivlerësimit në pretendimet përfundimtare kundërshtoi se ato janë dokumentuar në procesverbalet që janë pjesë e secilës prej dosjeve, sipas nenit 25, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”) dhe se duke mos pasur ankime nga palët, për shkak se janë vendime të paankimueshme, nuk ka pasur arsye ligjore që t'i arsyetonte veçmas, ndërkohë që kundërshton si të pasaktë pretendimin për mospasje të procesverbaleve gjyqësore.

11.3. Në lidhje me konstatimin për parregullsi gjatë veprimeve përgatitore dhe gjyqësore në mënyrën e njoftimit të palëve, kundërshton se është i pasaktë dhe nuk qëndron, pasi ato janë kryer në përputhje me ligjin, nuk ka pasur ndonjë konfuzion në lidhje me realizimin e njoftimeve apo me zhvillimin e seancave gjyqësore, çështjet janë zhvilluar normalisht, palët kanë marrë dijeni për seancat dhe kanë paraqitur pretendimet/prapësimet e tyre.

11.4. Në lidhje me konstatimin e referencës së gabuar të bazës ligjore në vendimin gjyqësor, parashtron se është bazuar në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 29.03.2012, sipas të cilit për zgjidhjen e çështjes gjykata nuk është e detyruar që të mbështetet vetëm në bazën ligjore të parashikuar nga pala paditëse në kërkesëpadi, dhe se baza ligjore e shënuar në pjesën hyrëse të vendimeve gjyqësore është baza ligjore e përcaktuar nga palët paditëse në kërkesëpadi të paraqitura prej tyre.

11.5. Në lidhje me provat e reja të marra pas kërkesës së Komisionerit Publik, fillimisht rithekson se informacioni që u kërkua nga këto burime, në zbatim të nenit 465 të K.Pr.Civile, nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, ka dalë përtej shkaqeve të ankimit të bërë fillimisht nga Komisioneri Publik, dhe në vijim parashtron se nuk rezulton ndonjë e dhënë negative për punën e tij si gjyqtar.

---

<sup>6</sup> Për aftin 30-ditor, subjekti i rivlerësimit parashtron se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, neni 72 i tij, është shfuqizuar neni 327 i K.Pr.Civile, i cili ishte në fuqi në vitin 2010 dhe ku është referuar vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010 i KLD-së, dhe se duhet pasur në vëmendje parashikimi i nenit 2, pika 1, germa “m” e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit standardet minimale të afatit janë orientuese, brenda të cilave një çështje duhet të përfundojë.

11.6. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga Komisioneri Publik për caktimin e një metodologjie, model, njësie matëse në funksion të qëllimit të ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit kundërshton se është një kërkim i cili nuk përputhet me parimet kushtetuese, pasi cenon parimet themelore, si: *gjykata e caktuar me ligj dhe siguria juridike*<sup>7</sup>.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### 12. Juridiksioni i Kolegjit

12.1. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet e subjekteve të rivlerësimit dhe të Komisionerit Publik kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e tyre, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentian Medja, me detyrë gjyqtar në Prokurorinë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet e Komisionerit Publik ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

##### 13. Legjitimimi i ankuesit

13.1. Ankuesi, Komisioneri Publik, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### 14. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14.1. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj

---

<sup>7</sup> Sipas subjektit të rivlerësimit, hartimi i një metodologjie të qartë e objektive bie ndesh me kërkesën për parashikueshmëri të pasojave që vijnë nga parashikime konkrete ligjore dhe po ashtu zbatimi uniform i rregullave të qarta e objektive që ligji parashikon në lidhje me vlerësimin profesional, duke iu referuar për këtë qëllim vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese, par. 52, 53 dhe 54, subjekti i rivlerësimit pretendon se është vendosur qartë kufiri ndarës për një vlerësim negativ, i cili është vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, por që nëpërmjet kërkesës për hartimin e një metodologjie të re vlerësimi, Komisioneri Publik tenton ta zhvendosë këtë kufi, dhe në rastin konkret situata që pretendohet të krijohet, sjell edhe cenim të së drejtës së ankimit, pasi nëse Kolegji do të marrë përsipër të krijojë një metodologji të re të vlerësimit profesional, ai si subjekt rivlerësimi do ta ketë të pamundur të parashtojë argumente kushtetuese.

vendimit të Komisionit nr. 60, datë 01.08.2018, për subjektin e rivlerësimit Gentian Medja, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike.

15. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se sipas përcaktimit të neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, organet ekzistuese të ngarkuara për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve apo prokurorëve, kanë rol ndihmës, por janë organet e rivlerësimit ato që kryejnë vlerësimin e aftësive profesionale, pa u kushtëzuar nga gjetjet e raporteve përkatëse. Me qëllim për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni duhet të administrojë të gjitha burimet dhe të vlerësojë të gjitha kriteret, bazuar në treguesit e përcaktuar në ligj, dhe njëkohësisht duhet të tregojë mënyrën se si janë administruar burimet dhe janë vlerësuar kriteret, bazuar në treguesit përkatës. Rezulton se Komisioni, nuk ka administruar të gjitha burimet, dhe një hetim i plotë dhe i gjithanshëm, në përputhje me përcaktimet ligjore, mund të realizohet vetëm nëpërmjet administrimit të plotë të burimeve të përcaktuara në ligj. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, sipas përcaktimit të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioneri Publik e ka shoqëruar ankimin kundër vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, drejtpërdrejt me metodologjinë e propozuar për vlerësimin në përgjithësi të kriterit të aftësive profesionale. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit, para se të shqyrtojë shkaqet e ankimit dhe të kundërankimit, në raport me vendimin e ankimit nga Komisioneri Publik, fillimisht çmon të ndalet te metodat, mënyrat dhe mjetet e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale dhe kompetencat e organeve të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të neneve A, Ç dhe E të Aneksit të Kushtetutës, dhe neneve 40-41 të ligjit nr. 84/2016.
16. Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas të drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative, se çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre dhe, në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore. Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, ka rëndësi garantimi se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, duke iu referuar *opinionit CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias*.
17. Trupi gjykues i Kolegjit, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji, brenda objektit dhe qëllimit të vlerësimit të aftësive profesionale, në përputhje me procedurat përkatëse ligjore, duke e bazuar vlerësimin në burimet, kriteret dhe treguesit e vlerësimit të aftësive profesionale, ndërkohë për rezultatin përfundimtar, vlerëson të evidentojë nëse

çështja konkrete ndodhet në kushtet e *opinioneve thjesht të pasakta* apo para *gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose para ekzistencës së një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara*.

18. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se metodologjia është pjesë e objektit të ligjit nr. 84/2016, që rregullon procesin e rivlerësimit kalimtar, për të 3 (tria) kriteret e rivlerësimit, përfshirë edhe vlerësimin e aftësive profesionale. Ligjvënësi ka vlerësuar të përfshijë në objektin e këtij ligji, duke përcaktuar ai vetë, nëpërmjet këtij ligji, tërësinë e metodave, mjeteve dhe mënyrave që duhet të përdoren gjatë procesit të rivlerësimit dhe që duhet të jenë në funksion të vlerësimit, ndër të tjera, edhe të aftësive profesionale. Duke i vështruar në tërësi përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, vërehet se ai përcakton shprehimisht apo me referim sipas rastit, burimet nga të cilat duhet të dalin provat e nevojshme, procedurën që duhet respektuar, kriteret dhe treguesit që duhet të dalin nga këto burime, për të mbërritur në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, bazuar në sa përcakton ky ligj.

18.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se hetimi i plotë dhe i gjithanshëm, parim në bazë të të cilit Komisioni duhet të administronte të gjitha burimet e vlerësimit të aftësive profesionale të përcaktuara me ligj dhe, bazuar në këto burime, të merrte në analizë çdo kriter dhe tregues të përcaktuar në ligj për vlerësimin e aftësive profesionale, nuk cenon parimin e sigurisë juridike, sepse ato përbëjnë detyrim ligjor të institucioneve të rivlerësimit.

Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar se subjektet e rivlerësimit vlerësohen sipas rastit për: i) cilësi të pranueshme apo të papranueshme në punë; ii) gjykim të drejtë apo të dobët; iii) respektim apo mosrespektim të të drejtave të palëve ose viktimave; si dhe iv) të qenit eficient dhe efektiv në masë të pranueshme apo të qenit joefektiv, për të mbërritur përfundimisht në kualifikimin “i aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”, sipas përcaktimit të nenit 44, pikat “a”, “b” dhe “c”.

19. Sipas nenit 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, burimet mbi të cilat vlerësohen subjektet e rivlerësimit, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët merren nga burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve<sup>8</sup>, ndërkohë

---

<sup>8</sup> Neni 77 i ligjit nr. 96/2016, përcakton: “Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime: a) dosja personale e magjistratit; b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të këtij ligji; c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91 të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara; ç) vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore ose aktet e hartuara prej prokurorit dhe të përzgjedhura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve/akteve të hartuara dhe të përzgjedhura prej prokurorit nuk duhet të jetë më shumë se 2 në vit; d) mendimi i kryetarit; dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit; e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në veprimtaritë trajnuese; ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo; f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese; g) kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit; gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të magjistratit”.

që procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm<sup>9</sup>.

**19.1.** Sipas përcaktimit të nenit E, pika 2, fjalia e dytë të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, në objektin e vlerësimit të aftësisë për gjyqtarët, përfshihen kriteret e *aftësitë për të gjykuar, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimi profesional*, bazuar në standardet e parashikuara në ligj (ligji nr. 84/2016, dhe me referim për procedurat e vlerësimit nga ky i fundit edhe në ligjin nr. 96/2016). Qëllimi i vlerësimit të aftësive profesionale sanksionohet drejtpërdrejt nga neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilës subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.

**19.1.1.** Subjekti i rivlerësimit kualifikohet “i aftë” për të kryer funksionin kur ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme, sipas përcaktimit të nenit E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe 44, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

**19.1.2.** Subjekti i rivlerësimit kualifikohet “me mangësi”, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, me pasojë detyrimin nga Komisioni për të kryer program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës me qëllim për të plotësuar këto mangësi brenda një viti, sipas përcaktimit të nenit E, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**19.1.3.** Subjekti i rivlerësimit kualifikohet “i papërshtatshëm”, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas përcaktimit të nenit E, pikat 1 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

**19.2.** Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kualifikimi i subjekteve të rivlerësimit, përkatësisht në *të aftë, me mangësi apo të papërshtatshëm*, kryhet duke çmuar në tërësi dhe rast pas rasti kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në treguesit përkatës, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilët rezultojnë të jenë të ndërthurur në tregues të natyrës *cilësore dhe të vlerësueshëm* dhe tregues të natyrës *sasiore dhe të matshëm*.

---

<sup>9</sup> Në ndryshim nga nenet 77, germa “ç”, 84, 90, pika 1, germa “dh”, dhe 91 të ligjit nr. 96/2016, përcakton “periudhë të ndryshme vlerësimi”, specifikisht 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, por që mund të shtrihet edhe nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale, sipas nenit 41, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe numër çështjesh/dosjesh/vendimesh të ndryshme, pasi 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dokumente të tjera ligjore të përzgjedhura me short, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, sipas nenit 43, pika 2 dhe shtojcës 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**19.3.** Sipas përcaktimit të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësive profesionale të gjyqtarit vlerësohet bazuar në aspektet e *njohurive ligjore* dhe *arsyetimit ligjor*, por pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

**19.3.1.** Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësia për të analizuar jurisprudencën.

**19.3.2.** Aspekti i arsyetimit ligjor të gjyqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë, si: qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.

**19.4.** Sipas përcaktimit të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë organizative, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit, vlerësohet në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës, për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe për të administruar dosjet gjyqësore.

**19.4.1.** Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i kushtohet çdo çështjeje, rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor ose të prokurorisë për një çështje.

**19.4.2.** Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

**19.4.3.** Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore ose të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes.

**19.5.** Sipas përcaktimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale vlerësohet nëpërmjet etikës në punë, integritetit dhe paanësinë.

**19.5.1.** Etika në punë e magjistratit, në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion, matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit.

**19.5.2.** Integriteti i magjistratit, në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, matet duke u bazuar në tregues të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve

dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit dhe/ose raportet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

**19.5.3.** Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave, matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi.

**19.6.** Sipas përcaktimit të nenit 76 të ligjit nr. 96/2016, kriteri i aftësisë personale dhe angazhimit profesional vlerësohen nëpërmjet aftësive të komunikimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe gatishmërisë për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

**19.6.1.** Aftësia e komunikimit të magjistratit matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale. Vlerësimi i aftësive drejtuese si kryetar me të paktën “shumë mirë” ka përparësi në vlerësimin si magjistrat, i cili kryhet pas vlerësimit si kryetar.

**19.6.2.** Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe në shkëmbimin e njohurive apo të përvojës profesionale me ta.

**19.6.3.** Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike.

**19.6.4.** Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar në informacionin e dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, në vlerësimin “shumë mirë” në rastet e përmbushjes së detyrimit ligjor për të marrë pjesë në formim vazhdues jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë vjetëve. Shkallët e tjera të vlerësimit përcaktohen me rend zbritës nga ky standard.

**20.** Për çështjen objekt shqyrtimi, për subjektin e rivlerësimit Gentian Medja, në funksion të provueshmërisë së fakteve që çojnë në vlerësimin e aftësive profesionale, janë administruar fillimisht nga Komisioni dhe më pas edhe nga Kolegji, dokumentet ligjore në kuptim të nenit 3,



pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që do të citohen më poshtë dhe nga të cilat janë nxjerrë të dhënat për vlerësimin e kritereve<sup>10</sup> të vlerësimit të aftësive profesionale të këtij subjekti.

## 20.1. Vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit

20.1.1. Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, “{\*\*\*}” kundër “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}”, dhe person i tretë “{\*\*\*},{\*\*\*},{\*\*\*}”.

20.1.2. Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, “A.Z., B.V., E.S., E.Xh., E.S., E.Dh., L.F., R.T.” kundër “{\*\*\*}”.

20.1.3. Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.10.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, “{\*\*\*} dhe {\*\*\*}” kundër “{\*\*\*},{\*\*\*}”, person i tretë “{\*\*\*}”.

## 20.2. Çështjet e caktuara me shortin e parë

20.2.1. Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 07.05.2015, “{\*\*\*}” kundër “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

20.2.2. Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.09.2016, “{\*\*\*},{\*\*\*},{\*\*\*},{\*\*\*},{\*\*\*}” kundër “{\*\*\*}”, person i tretë “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

20.2.3. Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 26.04.2016, “T.M.” kundër “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

20.2.4. Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 24.06.2014, “F.Ç.” kundër “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 22.09.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

20.2.5. Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 13.01.2014, “Q.Z.” kundër “{\*\*\*}” (në mungesë) dhe “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 11.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

## 20.3. Çështjet e caktuara me shortin e dytë

20.3.1. Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.05.2014, “N.H., I.F., N.H., V.H., Sh.P.” kundër “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 09.10.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

20.3.2. Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 30.10.2015, “P.N.” kundër “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

---

<sup>10</sup> Neni E, pika 2, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës, përcakton: “Vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj”.

**20.3.3.** Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.05.2015, “B.B.” kundër “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 27.07.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

**20.3.4.** Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 17.05.2016, “E.M.” kundër “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**20.3.5.** Çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 15.09.2014, “A.B.” kundër “{\*\*\*}”, që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

#### **20.4. Burime të tjera të administruara në dosjen e Komisionit**

**20.4.1.** Shkresa, kërkesë për informacion nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2018, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkresa, kthim përgjigjeje, nr. {\*\*\*} prot., datë 29.01.2018, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

**20.4.2.** Shkresa, kërkesë për informacion, nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2018, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, shkresa, dërgim informacioni, nr. {\*\*\*} prot., datë 01.06.2018, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, shkresa, dhënie informacioni, nr. {\*\*\*} prot., datë 01.06.2018, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresa, dërgim informacioni, datë 01.06.2018, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe shkresa, dërgim informacioni, nr. {\*\*\*} prot., datë 01.06.2018, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**20.4.3.** Shkresa, përcjellëse, nr. {\*\*\*} prot., datë 13.04.2018, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresa, relacion, nr. {\*\*\*} prot., datë 13.04.2018, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresa, dërgim informacioni, nr. {\*\*\*} prot., datë 13.04.2018, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**20.4.4.** Shkresa, kërkesë për informacion, nr. {\*\*\*} prot., datë 08.06.2018, e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, shkresa, kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion, nr. {\*\*\*} prot., datë 30.05.2018, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, shkresa, kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion, nr. {\*\*\*} prot., datë 30.05.2018, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

**20.4.5.** Analiza vjetore e vitit 2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**20.4.6.** Analiza vjetore e vitit 2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**20.4.7.** Shkresa, të dhënat mbi gjyqtarin Gentian Medja, nr. {\*\*\*} prot., datë 10.10.2017, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, shkresa, informacion mbi ankesat dhe procedimet disiplinore për gjyqtarin Gentian Medja për periudhën e rivlerësimit kalimtar 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, nr. {\*\*\*} prot., datë 10.10.2017 e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

**20.4.8.** Shkresa, përcjellëse, nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2017, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 20.10.2017, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dërgim statistikash.

**20.4.9.** Shkresa, dërgimi i statistikave për gjyqtarin Gentian Medja, nr. {\*\*\*} prot., datë 13.11.2017, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, shkresa, përcjellëse, nr. {\*\*\*} prot., datë 8.11.2017, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe shkresa, dërgim i statistikave të integruara për gjyqtarin Gentian Medja, nr. {\*\*\*} prot., datë 09.11.2017, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**20.5.** Burime të administruara gjatë shqyrtimit në Kolegj

**20.5.1.** Dosja personale e magjistratit, z. Gentian Medja, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**20.5.2.** Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, mendimi i kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

**20.5.3.** Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, informacion me shkrim nga Shkolla e Magjistraturës.

**20.5.4.** Axhenda<sup>11</sup> e seminarit me temë “Bashkëpunimi juridik mes vendeve të Ballkanit perëndimor në fushën civile, tregtare dhe familjare”, si dhe konfirmimi i pjesëmarrjes.

**21.** Aftësitë për të gjykuar<sup>12</sup>

**21.1.** Njohuri ligjore

**21.1.1.** Aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se vlerëson që është detyrë e organeve administrative që të respektojnë afatin në lidhje me zgjidhjen e ankimeve nga palët ankimuese, por se kjo gjykatë vlerëson se, në rastin kur organi administrativ kompetent shprehet përtej afatit 1-mujor, ky fakt nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute të vendimit, dhe se konform nenit 141 të K.Pr.Administrative, me kalimin e këtij afati, pala e interesuar ka të drejtë që t’i drejtohet gjykatës, por nëse pala e interesuar nuk e shfrytëzon këtë të drejtë të saj për t’iu drejtuar gjykatës, atëherë zgjidhja e çështjes vazhdon të mbetet në juridiksion të organit administrativ dhe vendimi i tij është absolutisht i pavlefshëm.

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se vetë fakti që paditësit kanë filluar një proces ndaj përgjegjës të departamentit nuk është argument

---

<sup>11</sup> {\*\*\*} seminar on {\*\*\*} in the {\*\*\*} on 02.04.2009 - 03.04.2009 Belgrade (organized by the European Commission’s DG Enlargement within the framework of the TAIEX Instrument).

<sup>12</sup> Referimi në dokumentet ligjore, në kuptim të nenit 3, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është kryer sipas rastit i plotë ose i pjesshëm, duke përfshirë të 13 çështjet e marra në analizë ose një pjesë të tyre, dhe duke marrë në konsideratë kompetencat që ka subjekti i rivlerësimit, si një gjyqtar i një gjykate administrative të shkallës së parë dhe për sa kohë që dokumentet ligjore të përzgjedhura janë të mjaftueshme për të vërtetuar faktet që lidhen me kriteret dhe treguesit përkatës.

i mjaftueshëm për të përjashtuar përgjegjësin e departamentit nga procedurat e provimit, dhe se konform nenit 24 të rregullores së Universitetit të Mjekësisë, përgjegjësi i departamentit është personi përgjegjës për organizimin e provimit, prandaj ai nuk mund të përjashtohet nga marrja në provim vetëm me argumentin se kanë filluar një proces ndaj tij, dhe se në çdo rast, qoftë për procedurën, qoftë për vlerësimin, studentët kanë të drejtë që të ankohen dhe ankesat e tyre, në mënyrë përfundimtare, zgjidhen nga dekani i fakultetit ose nga komisioni *ad hoc* i krijuar posaçërisht.

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.10.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se nga neni 640 i K.Civil, që të lindin detyrimet nga shkak jashtëkontraktor duhet që të ekzistojnë njëkohësisht 4 elemente, ekzistenca e dëmit, paligjshmëria e veprimit, ekzistenca e fajit, dhe midis veprimeve të të paditurve, moslidhjes së kontratës dhe mosrealizimit të fitimit nga pala paditëse, të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë dhe shkakësore, duke përfunduar se nga veprimet e palës së paditur, pala paditëse është skualifikuar dhe nuk është realizuar kontrata, duke i hequr mundësinë palës paditëse për të realizuar fitimin e kontratës.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 07.05.2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se konform nenit 869 të K.Civil, kur kontrata zgjidhet, zbatimi i veprës është bërë i pamundur si pasojë e një shkak që nuk mund t'i atribuohet asnjërës palë, porositësi paguan pjesën e veprës së kryer në kufijtë brenda të cilëve është e dobishme për të, në përpjesëtim me çmimin e caktuar për të gjithë veprën.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.09.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se pas kërkesës së palës paditëse, konform nenit 39, pika 3 e ligjit nr. 49/2012, gjykata vendos pushimin e gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 26.04.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka çmuar se Komisioni Disiplinor është i paligjshëm, sepse nuk vjen në përputhje me kërkesat e pikës 4 të Kreut I dhe të Kreut II “Organet disiplinore”, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, dhe se vendimet për marrjen e masave disiplinore janë absolutisht të pavlefshme, sepse nuk është zbatuar procedura për hetimin e rasteve, duke marrë me shkrim mendimin dhe kundërshtimet e paditësve dhe nuk janë njoftuar sipas kërkesave të nenit 59 “Kompetencat dhe masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 24.06.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka çmuar se, konform nenit 45 të ligjit nr. 49/2012, ndaj vendimit nuk mund të bëhet ankim, dhe se çmon se në rastin konkret vlera e aktit administrativ të ankuar është nën vlerën e parashikuar nga neni 45 i ligjit nr. 49/2012. Në vijim, arsyeton se pezullimi i lejes së drejtimit përbën dënim plotësues dhe, për rrjedhojë, ndjek fatin e dënimit kryesor, dhe çmon se përderisa për gjobën vendimi përbën formë të prerë, atëherë edhe për dënimin plotësues ai përbën vendim të formës së prerë, sepse këto

dy sanksione janë dhënë për të njëjtin fakt. Gjithashtu, arsyeton se gjatë gjykimit të një procesi gjyqësor, gjykata vlerëson provueshmërinë e faktit dhe bazueshmërinë në ligj të pretendimeve, dhe në këtë këndvështrim, vlerëson se përderisa gjykata çmon se nuk provohet fakti për të cilin organi administrativ ka dënuar paditësin me gjobë dhe ky vlerësim i subjektit të rivlerësimit përbën vendim të formës së prerë, atëherë ky vlerësim i gjykatës ka efekt edhe mbi dënimin plotësues, i cili do të ishte i paefektshëm, sepse vendimi gjyqësor për dënimin kryesor, në rastin konkret gjobën, është vendim i formës së prerë dhe, për rrjedhojë, konform nenit 451 të K.Pr.Civile, është i detyrueshëm për zbatim për të gjitha subjektet që u drejtohet, edhe për gjykatën, duke përfunduar se e drejta e ankimit lidhur me dënimin plotësues ndjek fatin e dënimit kryesor.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 13.01.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se marrëdhëniet e punës së paditësit me palën e paditur kanë zgjatur mbi 3 vjet, dhe në këto kushte paditësi gëzon të drejtën për të përfituar shpërblim për vjetërsi në punë me pagën e një 15-ditëshi për çdo 3 vjet punë, dhe konform nenit 145, pika 2 e Kodit të Punës, paga mbi të cilën do të jepet shpërblimi do të llogaritet në bazë të pagës që ekziston në përfundim të marrëdhënieve të punës.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.05.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi në tërësi çështjen, arriti në konkluzionin se, *së pari* ligji i aplikueshëm në lidhje me vlefshmërinë e vendimeve të ankimuara do të jetë ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, *së dyti* paditësit nuk legjitimohen në ngritjen e kësaj padie, dhe se është ligji nr. 10019, datë 29.02.2008, që parashikon mënyrën dhe procedurën e ankimit të vendimeve që merren nga organet që administrojnë zgjedhjet, si dhe që parashikon subjektet që kanë të drejtë të paraqesin ankim, *dhe në këtë* kuptim çmon se paditësit nuk janë subjekte zgjedhore.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 30.10.2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se konform nenit 9, pika 1 e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, deklarimi i pasurisë dhe i interesave privatë shoqërohet me një autorizim të veçantë, ku deklaruesi autorizon organet e përcaktuara në këtë ligj të verifikojnë të gjitha subjektet, private e publike, brenda dhe jashtë vendit, për të dhënat e deklaratës, dhe se mosdhënia e autorizimit brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit për deklarim, përbën shkak ligjor për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas legjislacionit përkatës.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.05.2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se në rastin konkret pala paditëse nuk ka plotësuar të metat e padisë, pasi parapakisht kishte argumentuar se konform nenit 25 të ligjit nr. 49/2012, gjyqtari kryesues i kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar një afat deri në 10 ditë, dhe se kur paditësi nuk i plotëson të metat e padisë brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendimin për kthimin e padisë dhe të akteve që i bashkëlidhen.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 17.05.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se ambienti në të cilin pala paditëse ushtronte aktivitetin (oborr i rrethuar me plastmasë për arsye të erërave dhe shiut) përfshihet në konceptin e një ambienti të mbyllur, pasi kishte argumentuar paraprakisht se konform nenit 3, pika 18 e ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, mjedis i mbyllur është a) një mjedis që ka një tavan ose çati, dyer, dritare ose rregullime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar plotësisht me mure të përhershme ose të përkohshme; b) një mjedis që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar me mure të përhershme ose të përkohshme, muret e të cilit kanë hapje të përhershme që nuk mund të hapen apo të mbyllen me sipërfaqe më pak se 50 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të mureve, duke përfunduar se ambienti në të tria anët e tij është i rrethuar me plastmasë, e cila zë një hapësirë më të madhe se 50% e sipërfaqes së përgjithshme të murit.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 15.09.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se lirimi nga detyra i paditësit nuk është bërë për një nga rastet që parashikon neni 66 i ligjit nr. 152/2013, nuk është bërë nga organi kompetent, njësia e burimeve njerëzore të institucionit dhe nuk është zbatuar procedura e parashikuar me ligj për dhënien e masave disiplinore.

#### 21.1.2. Aftësia e përgjithshme për të identifikuar konfliktin e normave

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.10.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se konform nenit 13 të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, të ratifikuar me ligjin nr. 10472, datë 20.10.2011, të dyja palët kontraktuese do të njohin në mënyrë reciproke certifikatat e {\*\*\*}-së për drejtuesit e mjeteve të lëshuara nga autoritetet kompetente respektive, dhe se referuar rastit konkret, kjo gjykatë vlerëson se në lidhje me mjetet borëpastruese, pala e paditur nuk mund të kërkojë që leja e qarkullimit të jetë e legalizuar apo me vulën *apostille*. Më tej vijohet se Kodi Rrugor parashikon mundësinë që mjetet e regjistruara në një shtet të huaj mund të lëvizin në territorin shqiptar dhe për lëvizjen e mjeteve kërkohen dokumentet e regjistrimit të shtetit të origjinës dhe leja ndërkombëtare e qarkullimit, dhe në këtë kuptim, për sa kohë mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës ka një marrëveshje për njohjen reciproke të këtyre akteve, kjo gjykatë vlerëson se këto akte nuk ka nevojë që të legalizohen apo t'u vendoset vula *apostille* në mënyrë që të jenë të përdorshme në Republikën e Shqipërisë.

#### 21.1.3. Aftësia e përgjithshme për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përdorur parimin e disponibilitetit, pasi e ka gjetur të pabazuar pretendimin e paditësve që të urdhërohet pala e paditur që të përcaktojë një datë tjetër për realizimin e provimit të paditësve, pasi konform neneve

6 dhe 28 të K.Pr.Civile do të shprehet vetëm mbi atë çfarë kërkohet nga palët, pa kaluar kufijtë e objektit të padisë.

#### 21.1.4. Aftësia për të analizuar jurisprudencën

- Nga kundërankimi nr. {\*\*\*} prot., datë 07.11.2018, rezulton se subjekti i rivlerësimi ka parashtruar se në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar neneve 850 dhe 869 të K.Civil, gjykata ka pasur në vëmendje konkluzionet e arritura nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 3, datë 29.03.2012, sipas të cilave gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar te dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Vijon se mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, por se nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë, dhe se në këtë rast arsyeton se gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar, duke përfunduar se në këtë kuptim, për zgjidhjen e çështjes, gjykata nuk është e detyruar që të mbështetet vetëm në bazën ligjore të parashikuar nga pala paditëse në kërkesëpadi.

#### 21.2. Arsyetimi ligjor

##### 21.2.1. Qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit<sup>13</sup>

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2014, rezulton se subjekti rivlerësimi ka arsyetuar se, pasi shqyrtoi në tërësi çështjen, arriti në konkluzionin se kërkesëpadija është e pabazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar, për këto arsye: *së pari*, se pala paditëse, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, legjitimohet për të paraqitur këtë padi; *së dyti*, duke iu referuar objektit të padisë, vlerëson se objekti i padisë është një objekt me kërkime të ndërvarura; *së treti*, pala paditëse, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, i është drejtuar gjykatës me padi objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ; *së katërti*, se vendimi nr. {\*\*\*}, datë 21.03.2013, i KPP-së nuk përbën një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm; dhe *së pesti*, gjykata çmon se kërkesëpadija duhet rrëzuar edhe për pikat e tjera të objektit të saj.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 24.6.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimi ka arsyetuar se pasi shqyrtoi në tërësi çështjen, arriti në konkluzionin se kërkesëpadija ishte e bazuar në ligj dhe në prova dhe, si e tillë, ajo duhet pranuar, dhe se në arritjen e këtij konkluzioni mbështetet në parashikimin e nenit 35/1 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, të kontratës administrative dhe të veprimit

---

<sup>13</sup> Neni 41 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “Përveç sa parashikohet në Kodin e Procedurës Civile, vendimi i gjykatës administrative përmban edhe: a) përcaktimin e qartë të çështjeve, në pjesën arsyetuese, të vlerësuar sipas nenit 37 të këtij ligji; b) përcaktimin në pjesën urdhëruese, se kur parashikohet një detyrim konkret i palës së paditur, ai është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor. Në këtë rast gjykata përcakton afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit.”

tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Vijon se, në rastin konkret, për të provuar faktin e pretenduar, pala e paditur paraqiti procesverbalin e konstatimit të shkeljes, në të cilin paditësi nuk ka nënshkruar, dhe në këto kushte gjykata ka çmuar se ky procesverbal nuk mund të shërbejë si provë e plotë në lidhje me provimin e faktit të pretenduar, dhe kjo sepse përbën një akt të plotësuar, tërësisht të njëanshëm.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 17.05.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit pasi e shqyrtoi në tërësi çështjen, vlerësoi se me të drejtë pala e paditur ka dënuar paditësen me gjobë për shkelje të nenit 15, pika 1 e ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, dhe se gjen të pabazuar pretendimin e palës paditëse se ambienti nuk ishte i mbyllur, duke u bazuar në përcaktimet që i jep mjedisit të mbyllur neni 3, pika 18 e ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006.

#### 21.2.2. Struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit<sup>14</sup>

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2014, rezulton se pjesa hyrëse përmban trupin gjykues sipas përbërjes, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditës, të paditur, personin e tretë), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, kurse në pjesën përshkruese/arsyetuese përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, dhe në pjesën urdhëruese përmendet çfarë vendosi gjykata<sup>15</sup>.

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2016, rezulton se pjesa hyrëse përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët, duke shënuar identitetin (paditësit, të paditurit), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të

---

<sup>14</sup> Neni 41 i ligjit nr. 49/2012, përcakton: “Përveç sa parashikohet në Kodin e Procedurës Civile, vendimi i gjykatës administrative përmban edhe: a) përcaktimin e qartë të çështjeve, në pjesën arsyetuese, të vlerësuara sipas nenit 37 të këtij ligji; b) përcaktimin në pjesën urdhëruese, se kur parashikohet një detyrim konkret i palës së paditur, ai është i ekzekutueshëm nga përbaruesi gjyqësor. Në këtë rast gjykata përcakton afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit”. Neni 310 i K.Pr.Civile, përcakton: “Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. (I). Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden: 1) gjykata që ka gjykuar çështjen, 2) trupi gjykues dhe sekretari, 3) koha dhe vendi i dhënies së vendimit, 4) palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, ndërhyrës, si dhe përfaqësuesit e tyre, 5) emri i prokurorit, nëse ka marrë pjesë, 6) objekti i padisë, 7) kërkimet përfundimtare të palëve, 8) mendimi i prokurorit nëse ka marrë pjesë. (II). Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden: 1) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit, dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata, 2) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, 3) dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi. Vendimi i gjykatës për paditë me vlerë deri në 150000 lekë duhet të përmbajë hyrjen dhe pjesën urdhëruese, sipas pikës 1 të këtij neni. Nëse palët, brenda tri ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, njoftojnë me shkrim gjykatën se do ta ankimojnë vendimin, gjykata arsyeton vendimin dhe ua njofton palëve. (III). Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden: 1) çfarë vendosi gjykata, 1/1) nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre dhe se vendimi është i ekzekutueshëm nga përbaruesi gjyqësor, 2) kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, 3) e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij”.

<sup>15</sup> Ekzekutueshmëria e vendimit nuk përmendet, por është rrëzim i kërkesëpadisë, si dhe të drejtën e ankimit me afat të përcaktuar, si dhe shpenzimet gjyqësore.



palëve, në pjesën përshkruese/arsyetuese përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në pjesën urdhëruese përmendet çfarë vendosi gjykata<sup>16</sup>, si dhe shpenzimet gjyqësore.

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.10.2016, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditësin, të paditurin, personin e tretë), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata, ekzekutueshmëria e vendimit dhe mënyra e ekzekutimit (detyrimin për të paguar shumat konkrete), të drejtën e ankimit me afat të përcaktuar si dhe shpenzimet gjyqësore.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 07.05.2015, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban trupin gjykues sipas përbërjes, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditës, e paditur), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në pjesën *urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata<sup>17</sup>, mosankimueshmëria e vendimit, si dhe shpenzimet gjyqësore.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.09.2016, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditësin, të paditurin, personin e tretë), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata<sup>18</sup>, e drejta e ankimit në afatin e caktuar, si dhe shpenzimet gjyqësore.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 26.04.2016, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditësin, të paditurin), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata, ekzekutueshmëria e vendimit dhe mënyra e ekzekutimit (rikthimin në punë dhe pagimin e pagës nga momenti i ndërprerjes deri në ekzekutim), e drejta e ankimit në afatin e caktuar, si dhe shpenzimet gjyqësore.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 24.06.2014, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditës, e paditur), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese*

---

<sup>16</sup> Ekzekutueshmëria e vendimit nuk përmendet, por është pjesërisht shfuqizim procedure (pa detyrim konkret) dhe pjesërisht rrëzim, si dhe të drejtën e ankimit me afat të përcaktuar.

<sup>17</sup> Ekzekutueshmëria e vendimit nuk përmendet, por është rrëzim padie.

<sup>18</sup> Ekzekutueshmëria e vendimit nuk përmendet, por është pushim gjykimi.

përmendet çfarë vendosi gjykata, ekzekutueshmëria e vendimit dhe mënyra e ekzekutimit (pranim padie, kthimin paditësit të shumës së gjobës dhe lejen e drejtimit, por pa caktuar afatin), si dhe të drejtën e ankimit<sup>19</sup>.

- Nga çështja nr. regj. them {\*\*\*}, datë 13.01.2014, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditës, të paditur), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata, mënyra e konkrete e ekzekutimit (pagimin e pagës, masën dhe afatet), të drejtën e ankimit por pa caktuar afatin, si dhe të drejtën e ankimit në afatin e caktuar dhe shpenzimet gjyqësore.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.05.2014, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët, duke shënuar identitetin (paditës, të paditur), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata, e drejta e ankimit në afatin e caktuar, si dhe shpenzimet gjyqësore.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 30.10.2015, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditës, të paditur), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata dhe mënyra e konkrete e ekzekutimit (për sa i përket masës së gjobës si dënim administrativ, proporcionalisht me shkeljen), mospasjen e të drejtës së ankimit (për shkak të vlerës së padisë 100.000 lekë), si dhe shpenzimet gjyqësore.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.05.2015, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditës, të paditur), objektin e padisë dhe bazën ligjore, nuk përmban kërkimet përfundimtare të palëve dhe në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes që kanë të bëjnë me të metat e kërkesëpadisë dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata në drejtim të pasojës, të drejtën e ankimit të veçantë, shpenzimet gjyqësore nuk përmenden, por ishte një prej shkaqeve që kërkesëpadia u kthye me të meta.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 17.05.2016, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditës, të paditur), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet e palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata, mënyra e konkrete e ekzekutimit (pagimi i pagës, masa dhe afatet), e drejta e ankimit (por pa caktuar afatin), si dhe shpenzimet gjyqësore.

---

<sup>19</sup> Pa afat të përcaktuar.

- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 15.09.2014, rezulton se *pjesa hyrëse* përmban gjyqtarin, sekretaren, datën (ora dhe vendi nuk përmenden) e dhënies së vendimit, palët duke shënuar identitetin (paditës, të paditur), objektin e padisë dhe bazën ligjore, kërkimet përfundimtare të palëve, në pjesën *përshkruese/arsyetuese* përmenden rrethanat e çështjes, përfundimet e nxjerra nga gjykata, provat, arsyet dhe dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, në *pjesën urdhëruese* përmendet çfarë vendosi gjykata, mënyra e konkrete e ekzekutimit (shfuqizimi i aktit administrativ, kthimi në punë i paditësit dhe detyrimi për të shlyer pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin në vendin e mëparshëm), e drejta e ankimit në afatin e caktuar, si dhe shpenzimet gjyqësore.

### 21.2.3. Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se *së pari* vlerëson legjitimitimin për të ngritur padi, dhe pas hetimit të rrethanave të faktit kërkimin në themel, i cili është në drejtim të konstatimit të pavlefshmërisë absolute të aktit, si të pabazuar.
- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se vlerëson të shprehet brenda kufijve të kërkimit dhe në vijim çmon të vlerësojë pavlefshmërinë e procedurës për shkak të mungesës së autorizimit ligjor të përgjegjësit të departamentit (kompetencës si shkak pavlefshmërie absolute).
- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka çmuar të vlerësojë pabazueshmërinë e pretendimit për ngritjen e padisë jashtë afatit, të pretendimit për mospasjen e vulës *apostille*, për mosshlyerjen e detyrimeve për energjinë elektrike, si dhe të lidhjes shkakësore midis veprimit të palës së paditur dhe heqjes së mundësisë për të realizuar fitimin, dhe se në themel e gjen të pabazuar padinë, sepse kriteri kryesor për përcaktimin e një oferte si fituese nuk është çmimi më i ulët, por shërbimi/malli/puna më e mirë që përmbush kriteret kualifikuese.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 07.05.2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka çmuar se mosekzekutimi i plotë i kontratës, por vetëm pjesërisht, nuk ka ardhur për shkak të palës së paditur, e cila është paguar në përputhje me volumin e punës së kryer dhe, për këtë arsye, ajo nuk mund të detyrohet që të kthejë shumën e përfituar për efekt të punës së kryer.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.09.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka çmuar të pushojë padinë, i gjendur në kushtet e heqjes dorë nga paditësi.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 26.04.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit *së pari* vlerëson legjitimitimin për të ngritur padi, afatin e ngritjes së padisë, i gjendur në kushtet e mosnjohimit të aktit, barrën e provës e cila binte mbi palën e paditur (organin publik), faktin se vetëm mosprezenca në punë në datën 23.11.2015 nuk është shkelje e rëndë, pasi ajo nuk është e përsëritur, dhe prandaj vendimi i Komisionit Disiplinor duhej shfuqizuar.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 24.06.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se barra e provës për të provuar ligjshmërinë binte mbi organin publik, dhe se raporti i shërbimit është një akt i njëanshëm i mbajtur nga pala e paditur dhe nuk shërben për të provuar shkeljen.

- Nga çështja nr. regj. them {\*\*\*}, datë 13.01.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka çmuar se palët kontraktore mund të zgjidhin kontratën me afat të caktuar para mbarimit të afatit vetëm në rastet kur ka shkaqe të arsyeshme, dhe se barrën e provës e ka punëdhënësi.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.05.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se paditësit janë pjesëtarë të listave shumemërore të propozuara nga partitë politike, si kandidatë për këshilltarë në {\*\*\*} për zgjedhjet vendore të datës 08.05.2011, dhe se padia është ngritur në titull personal, si kandidatë të propozuar nga partitë politike, dhe nuk është paraqitur nga partitë politike.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 30.10.2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se anëtari i familjes dhe personi i lidhur me subjektin deklarues mbajnë përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara, dhe se në rastin konkret rezulton se nuk është firmosur formulari i autorizimit nga bashkëshortja e paditësit në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës 2007 dhe në deklaratat periodike vjetore të viteve 2009, 2010, 2011.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 21.05.2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se pala paditëse ka marrë dijeni për plotësimin e të metave të padisë në dosje më datë 29.05.2015, dhe se nuk ka plotësuar të metat në afatin e caktuar nga gjykata, me pasojë kthimin e padisë.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 17.05.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se ambienti në të cilin pala paditëse ushtron aktivitet përfshihet në konceptin e një ambienti të mbyllur, sipas parashikimeve të nenit 18, pika 3 e ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.
- Nga çështja nr. regj. them. {\*\*\*}, datë 15.09.2014, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se lirimi nga detyra i paditësit nuk është bërë për një nga rastet që parashikohen nga neni 66 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, nuk është bërë nga organi kompetent, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, dhe nuk është zbatuar procedura e përcaktuar në ligj për dhënien e masave disiplinore.

**Për sa më sipër, pas vlerësimit të treguesve respektivë, në bazë të të dhënave të nxjerra nga burimet e vlerësimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit, përmbush kriterin e aftësive profesionale për të gjykuar, pasi:**

a) Në drejtim të njohurive ligjore:

- i) sqaron kuptimin e normave që zbaton, duke demonstruar aftësi të përgjithshme për të interpretuar ligjin;
- ii) në rast përplasjeje të normave, zbaton ato norma ligjore që janë të zbatueshme me përparësi për çështjen konkrete, duke identifikuar konfliktin e normave;
- iii) evidenton institutet ligjore, duke përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës;
- iv) i referohet për zbatimin e ligjit praktikës njësuere të Gjykatës së Lartë, duke demonstruar aftësi për të analizuar jurisprudencën.

b) Në drejtim të arsytimit ligjor:

- i) vendimet e hartuara janë të shprehura rrjedhshëm në tërësinë e tyre, janë të mirëpërcaktuara zhvillimet e ngjarjeve brenda tyre, janë shmangur dyshimet dhe ngatërresat, si dhe pikat e errëta ose të pazgjidhura dhe, si pasojë, të qarta dhe të kuptueshme;
- ii) në vendimet e hartuara, struktura është e qëndrueshme dhe e mirorganizuar, me renditje të rregullt të pjesëve përbërëse të tyre, pjesës hyrëse, pjesës përshkuese dhe pjesës urdhëruese, sikurse edhe e elementeve të secilës pjesë;
- iii) evidenton institutet ligjore duke përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës;
- iv) në vendimet e hartuara, në tërësisë e tyre, vërehet lidhje e brendshme, e rregullt dhe e domosdoshme e zhvillimeve në përmbajtje dhe, si pasojë, demonstroi cilësi në analizë dhe argumentim logjik.

## 22. Aftësitë organizative

22.1. Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës

22.1.1. Respektimi i afateve ligjore<sup>20</sup>

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2014, rezulton se çështja është regjistruar në datën 18.02.2014, veprimet përgatitore janë kryer në datën 21.02.2014<sup>21</sup>, seancat përgatitore janë

---

<sup>20</sup> Neni 25, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, në lidhje me veprimet përgatitore, përcakton: “Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime: [...]”. Neni 27, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, në lidhje me urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore, përcakton: “Gjyqtari, pasi sigurohet për kryerjen e të gjitha veprimeve përgatitore, menjëherë nxjerr urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore. Afati për zhvillimin e seancës gjyqësore nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë. [...]”. Neni 28, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, në lidhje me sigurimin e padisë, përcakton: “[...] Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull, kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët. [...]”. Neni 302 i K.Pr.C., në lidhje me përfundimin e hetimit gjyqësor, përcakton: “Pasi të jenë shqyrtuar të gjitha provat që gjykata ka pranuar të merren, pyeten palët nëse kanë kërkesa të tjera në dobi të gjykimit të çështjes dhe në rast se ato nuk pranohen, gjykata i jep fund hetimit gjyqësor dhe fton palët të parashtrajnë pretendimet përfundimtare të tyre rreth çështjes në gjykim. Si rregull, ato i parashtrohen gjykatës me shkrim. Me kërkesën e palëve, kur kjo shihet me vend, gjykata u jep atyre një afat deri në 5 ditë, për të përgatitur parashtrësat e tyre”. Neni 42, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[...] Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsytuar të vendimit deri në 5 ditë. [...]”. Neni 42, pika 3 e ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[...] Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore”.

<sup>21</sup> Nga procesverbali i veprimeve përgatitore, datë 21.02.2014, vërehet se: “[...] Vendosi: Caktimin e seancës përgatitore më datë 18.03.2014, ora 12:00. Të njoftohen palët [...]”.

zhvilluar në datat 18.03.2014<sup>22</sup>, 31.03.2014<sup>23</sup>, 16.04.2014<sup>24</sup>, 08.05.2014<sup>25</sup>, 27.05.2014<sup>26</sup>, 17.06.2014<sup>27</sup>, 09.07.2014<sup>28</sup>, seancat gjyqësore janë zhvilluar në datat 16.07.2014<sup>29</sup>, 10.09.2014<sup>30</sup>,

---

<sup>22</sup> Nga procesverbali i seancës përgatitore, datë 18.03.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Gjykata bazuar në nenin 161 të K.Pr.C. vendosi pranimin e kërkesës për thirrjen në cilësinë e palës së paditur të ndërgjygjësisë {\*\*\*}, meqenëse është kërkesë e palës paditëse [...] Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 185 të K.Pr.C. vendos pranimin e kërkesës për ndryshimin e objektit të padisë sipas kërkesës së palës paditëse. Baza ligjore mbetet e pandryshuar. [...] Vendim: Meqenëse në nenin 21, par. 2 i ligjit nr. 49/2012, parashikohet që paditësi, përveç aktit administrativ që kundërshton, nuk ka detyrim t’i bashkëlidhë aktet provuese, por nëse i paraqet ato, duhet t’i paraqesë edhe kopje të tyre për të paditurin, kjo gjykatë vëren se pala paditëse duhet të paraqesë 3 kopje të akteve. Në këtë rast, pala paditëse duhet të paraqesë 3 kopje të padisë dhe 3 kopje të akteve. Në këtë rast, meqenëse në këtë gjykim u thirr në cilësinë e palës së paditur edhe {\*\*\*} dhe nga pala paditëse u ndryshua objekti i padisë, konform nenit 21 të ligjit nr. 49/2012, gjykata çmon se pala paditëse duhet të paraqesë, përveç padisë, edhe aktet që t’u njoftohen palëve të paditura, me qëllim që të paraqesin prapësimet rreth objektit të ndryshuar. Për këtë arsye, gjykata vendosi: T’i lërë afat palës paditëse që brenda datës 31.03.2014: të depozitojë pranë gjykatës tri kopje të kërkesëpadisë dhe tri kopje të akteve. Në të kundërt, konform nenit 25/1 të ligjit nr. 49/2012, me kalimin e afatit të caktuar, kërkesëpadia do t’i kthehet pa veprime. Verifikimi i plotësimin të kësaj të mete të kërkesëpadisë nga pala paditëse do të bëhet brenda datës 31.03.2014”.

<sup>23</sup> Nga procesverbali i veprimeve përgatitore të datës 31.03.2014, vërehet se: “[...] Vendosa: T’i njoftoj palës së paditur kërkesëpadinë dhe aktet e paraqitura nga paditësi. Të njoftoj palën e paditur që deri në 10 ditë nga data e marrjes së njoftimit, të depozitojë në sekretari: 1) prapësimet me shkrim; 2) listën e personave, që kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit dhe adresat e tyre; 3) aktet e plota shkresore, në të cilat është bazuar kryerja e veprimit administrativ. Seanca e realizimit të këtij veprimi do të bëhet brenda datës 16.04.2014”.

<sup>24</sup> Nga procesverbali i veprimeve përgatitore të datës 16.04.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Në mënyrë që edhe pala e paditur të njoftohet me provat dhe prapësimet eventuale të palës së paditur, bazuar në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012 [...] Vendosi: Caktimin e seancës përgatitore më datë 08.05.2014, ora 12:00. Të njoftohen palët [...]”.

<sup>25</sup> Nga procesverbali i seancës përgatitore të datës 08.05.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Gjykata bazuar në nenin 175 të K.Pr.Civile vendos shtyrjen e seancës për arsye se nuk provohet marrja dijani për palën paditëse. Seanca përgatitore caktohet më datë 27.05.2014, ora 13:30. Palët prezente morën dijani. Të njoftohet pala paditëse [...]”.

<sup>26</sup> Nga procesverbali i seancës përgatitore të datës 27.05.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Gjykata vendos pranimin e kërkesës për ndërhyrje dytësore të palëve shoqëria “{\*\*\*}” ShA, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, si palë të tretë. [...] Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 49/2012, i lë afat palës paditëse t’i paraqesin një kopje të provave për palën e tretë. [...]”.

<sup>27</sup> Nga procesverbali i seancës përgatitore të datës 17.06.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012, vendos shtyrjen e seancës për t’u lënë afat palëve për të paraqitur prapësimet përpara seancës së parë gjyqësore. [...]”.

<sup>28</sup> Nga procesverbali i seancës përgatitore të datës 09.07.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Pasi verifikova aktet e dosjes, vlerësoj se veprimet përgatitore janë kryer të plota dhe, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 49/2012, Urdhëroj: Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. [...]”.

<sup>29</sup> Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 16.07.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Gjykata bazuar në nenin 175 të K.Pr.Civile vendos shtyrjen e seancës për arsye se nuk provohet marrja dijani për {\*\*\*} Tiranë”.

<sup>30</sup> Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 10.09.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 302 të K.Pr.Civile, vendos t’i japë fund hetimit gjyqësor dhe shtyhet për konkluzionet përfundimtare. Palët kërkojnë t’i bëjnë me shkrim konkluzionet. [...] Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 302 të K.Pr.Civile, vendos shtyrjen e seancës gjyqësore për t’u lënë kohë palëve për të paraqitur pretendimet përfundimtare me shkrim”.

16.09.2014<sup>31</sup>, 23.09.2014<sup>32</sup>, vendimi është shpallur në datën 29.09.2014<sup>33</sup>, s'ka të dhëna për dorëzimin e dosjes në sekretari, por rezulton se dëftesa e komunikimit të vendimit të arsyetuar është bërë në datën 14.10.2014, ankimi i vendimit (për zënie të afatit ligjor) është bërë në datën 11.12.2014 nga pala paditëse, ndërkohë që s'ka të dhëna për vendimin e pranimit të ankimit.

- Nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2016, rezulton se çështja është regjistruar në datën 08.06.2015, veprimet përgatitore janë kryer në datën 12.06.2015<sup>34</sup>, datën 25.06.2015<sup>35</sup>, datën 16.07.2015<sup>36</sup>, seanca përgatitore është zhvilluar në datën 15.09.2015<sup>37</sup>, seanca gjyqësore është zhvilluar në datën 30.09.2015<sup>38</sup>, seanca për pretendimet përfundimtare është zhvilluar në datën

---

<sup>31</sup> Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 16.09.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 49/2012, vendos shtyrjen e gjyqësore për arsye se nuk formohet trupi gjykues.”.

<sup>32</sup> Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 23.09.2014, vërehet se: “[...] Vendim: Gjykata, bazuar në nenin 42 të ligjit nr. 49/2012, vendos shtyrjen e seancës gjyqësore për shpalljen e vendimit”.

- gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit, gjyqtari Gentian Medja ka gjykuar dhe përfunduar me vendim 1864<sup>81</sup> çështje, nga të cilat 1138 janë çështje administrative, 219 janë çështje me objekt marrëdhëniet e punës, pra gjithsej me palë kundërshtare 1357, dhe 507 janë çështje të tjera pa palë kundërshtare (urdhura ekzekutimi, rivendosje në afat, disponim ankimi etj.). Gjatë kësaj periudhe atij i janë shortuar për gjykim 2093 çështje<sup>82</sup>. Në këto kushte, duke krahasuar këto të dhëna, vlerëson se gjyqtari paraqet një efektshmëri të lartë në detyrë<sup>83</sup>;
- duke mbajtur në konsideratë të gjithë procesin gjyqësor, nga paraqitja e padisë deri në dhënien e vendimit dhe zbardhjen e tij, numrin e lartë të çështjeve dhe kompleksitetin<sup>84</sup> e tyre, larminë e çështjeve që paraqiten në këtë gjykatë, numrin e lartë të çështjeve të vendimuara dhe

---

<sup>81</sup> Aq çështje sa mund të gjykohen nga trupa gjyqësore e një gjykate mesatare përgjatë një viti. (Nga vlerësimi përfundimtar i gjyqtarit Gentian Medja për periudhën 01.01.2007 - 31.12.2009 të KLD-së, në f 6, rezulton se sipas Inspektoratit të KLD-së: “Nga analiza e të dhënave statistikore konstatohet se përgjatë 3 viteve 2007-2009, gjyqtari Gentian Medja ka gjykuar gjithsej 964 çështje gjyqësore, nga të cilat 841 çështje gjyqësore brenda afateve standarde, ndërsa 123 çështje gjyqësore jashtë afateve standarde. Çështjet që kanë tejkaluar afatin standard zënë masën prej 12,7 % të çështjeve të gjykuara në periudhën e vlerësimit, duke qenë në nivelin “Shumë mirë”, në raport edhe me ngarkesën e lartë sasiore që ai ka pasur.”).

<sup>82</sup> Duhet të kihet parasysh, sipas kryetarit të GjAShP Tiranë, fakti që ngarkesa më e madhe për gjyqtarin në fjalë dhe për trupën gjyqësore të kësaj gjykate, është krijuar në vitet 2014, 2015. Veçanërisht në 3-mujorin e parë të vitit 2014, në zbatim të vendimit unifikues nr. 3, datë 06.12.2013, të Gjykatës së Lartë, nga gjykatat e rretheve gjyqësore janë përcjellë për kompetencë lëndore në këtë gjykatë 1890 çështje, të shpërndara në 16 gjyqtarë. Po kështu, duhet të mbahet parasysh fakti se ligji nr. 49/2012, sa i takon gjykimin në shkallë të parë, nuk ka asnjë parashikim për kohëzgjatjen e procesit, po vetëm afate procedurale të caktuara (brenda 7 ditëve nga paraqitja e padisë, gjyqtari kryesues vë çështjen në lëvizje, ose duke lënë afat për plotësimin e të metave paditësit, ose duke i kërkuar palës së paditur që deri në një afat 10-ditor të paraqesë prapësimet e saj dhe aktet provuese, neni 25 i ligjit etj.).

<sup>83</sup> Kryetari i GjAShP Tiranë, në dhënien e këtij mendimi, ka parasysh natyrën, kompleksitetin dhe sasinë e çështjeve të regjistruara në këtë gjykatë, e cila për nga natyra e saj gjykon çështje komplekse si për sa i takon faktit, ashtu edhe legjislacionit të zbatueshëm, dhe të cilat kërkojnë angazhim kohor për gjykimin e tyre.

<sup>84</sup> Kryetari i GjAShP Tiranë sjell në vëmendje faktin se mbi 90% e seancave gjyqësore nga gjyqtari janë zhvilluar në sallën e gjykimin dhe janë regjistruar në mënyrë audio, dhe se duhet mbajtur parasysh se sistemi {\*\*\*} i regjistrimit të seancave gjyqësore ka filluar të funksionojë në muajin qershor 2015 në GjAShP Tiranë.



angazhimit maksimal të shfaqur nga gjyqtari Gentian Medja në ushtrimin e funksioneve të tij si gjyqtar, respektimin e detyrave procedurale dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të procesit nga ana e tij, mendon se ai duhet vlerësuar pozitivisht në lidhje me këto kritere.

- Për kriterin e *etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale*, sipas përcaktimit të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, kryetari i GjAShP Tiranë, mendon se duhet vlerësuar *shkëlqyeshëm* ose *shumë mirë*, sipas ligjit nr. 96/2016, ose *i aftë* sipas ligjit nr. 84/2016:

- lidhur me treguesin *etika në punë të magjistratit në lidhje me angazhimit dhe përgjegjshmërinë në funksion*, mendon se është gjyqtar i cili karakterizohet nga një etikë e lartë në kryerjen e funksionit dhe një komunikim shumë korrekt me palët dhe të gjitha subjektet e tjera procedurale, dhe se gjatë periudhës së rivlerësimit gjyqtari ka qenë i angazhuar në lidhje me realizimin e funksionit të tij si gjyqtar, duke respektuar maksimalisht orarin zyrtar, urdhrat e kryetarit mbi shfrytëzimin e sallave të gjykimit dhe detyrat e tij si gjyqtar në lidhje me proceset gjyqësore. Nga ana e kryetarit të GjAShP Tiranë, nuk është konstatuar asnjë rast ku gjyqtari të ketë zhvilluar seancë përgatitore apo gjyqësore pa qenë i veshur me veshje të posaçme të gjyqtarit;

- lidhur me treguesin *integriteti i magjistratit në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm*, mendon se është gjyqtar me integritet dhe nuk i rezultojnë të dhëna të cilat cenojnë imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi të jashtëm;<sup>85</sup>

- lidhur me treguesin *paanësia e magjistratit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë*, mendon se ushtron funksionin e tij në paanësi të plotë dhe tregon kujdes në lidhje me konfliktin e interesit<sup>86</sup>.

- Për kriterin e *aftësive personale dhe angazhimit profesional*, sipas përcaktimeve të nenit 76 të ligjit nr. 96/2016, mendon se duhet vlerësuar *shkëlqyeshëm* ose *shumë mirë*, sipas ligjit nr. 96/2016, ose *i aftë* sipas ligjit nr. 84/2016, përmbledhtazi duke argumentuar se:

---

<sup>85</sup> Vlerësimi i kryetarit të GjAShP Tiranë, për këtë tregues, bazohet në rastet të cilat gjyqtari ka dhënë dorëheqjen, të cilat kanë qenë të motivuara dhe nuk ka ndonjë rast kur ai të ketë paraqitur dorëheqje ku të krijohet dyshimi se kjo dorëheqje ka ardhur si pasojë e ndikimit ose presionit të jashtëm.

<sup>86</sup> Sipas Kryetarit të GjAShP Tiranë, në rastet kur gjyqtari ka vlerësuar se ndodhet në kushtet të cilat mund të vënë në dyshim paanësinë e tij, ai ka paraqitur dorëheqjen dhe nuk ka ndonjë rast, që kërkesat për përjashtimin e tij nga gjykimi të jenë pranuar nga gjykata për konflikt interesi. Duke vijuar, kryetari i GjAShP Tiranë, shprehet se: i) në vitin 2014 janë paraqitur prej tij 9 dorëheqje, nga të cilat janë pranuar 8 dhe një është mospranuar; ii) në vitin 2015 janë dhënë 13 dorëheqje, të cilat janë pranuar të gjitha; dhe iii) deri në muajin tetor 2016 janë dhënë 11 dorëheqje, nga të cilat janë pranuar 8. Këto raste dorëheqjeje, vijon kryetari i GjAShP Tiranë, kanë të bëjnë me çështje të cilat më parë ishte vendosur pushimi apo kthimi i akteve nga gjyqtarë të tjerë, dhe me vendim të kryetarit të GjAShP Tiranë, sipas praktikës, për këto raste, është pranuar dorëheqja e gjyqtarit me këtë shkak dhe çështjet u kanë kaluar gjyqtarëve të cilët kanë vendosur pushimin ose kthimin e padisë. Sa u takon kërkesave për përjashtim të paraqitura ndaj gjyqtarit në periudhën e rivlerësimit, numri i tyre është 6, nga të cilat 4 kërkesa të rrëzuara, një e pushuar dhe një e pranuar.

- lidhur me treguesin e *aftësive të komunikimit të magjistratit*, ai paraqet një gjuhë të qartë komunikimi dhe është transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale;<sup>87</sup>
- lidhur me treguesin *aftësia për të bashkëpunuar me kolegët*, ai është tërësisht korrekt;<sup>88</sup>
- lidhur me treguesin *gatishmëria për t'u angazhuar në veprimet e veprimtari të tjera*, ai ka qenë i disponueshëm për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose trajnimit të magjistratëve të rinj, dhe është angazhuar në trajnimitin profesional të kandidatëve për magjistratë.

### 23.1.3. Vendimet përfundimtare për masat disiplinore

- Nga shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 29.10.2018, e KLD-së, rezulton se për gjyqtarin Gentian Medja nuk rezulton të jetë marrë deri më tani masë disiplinore apo të jetë kërkuar marrja e një mase të tillë nga ana e ministrit të Drejtësisë.

## 23.2. Integriteti i magjistratit ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm

### 23.2.1. Rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.10.2018, e KLD-së, rezulton se për gjyqtarin Gentian Medja nuk rezulton të jetë marrë deri më tani masë disiplinore apo të jetë kërkuar marrja e një mase të tillë nga ana e ministrit të Drejtësisë.

### 23.2.2. Vendimet përfundimtare për masat disiplinore

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.10.2018, e KLD-së dhe shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjASHP Tiranë, rezulton se për gjyqtarin Gentian Medja nuk rezulton të jetë marrë (deri në ato momente) masë disiplinore apo të jetë kërkuar marrja e një mase të tillë nga ana e ministrit të Drejtësisë, përkundrazi, sipas mendimit të kryetarit të GjASHP Tiranë, është gjyqtar me integritet dhe nuk i rezultojnë të dhëna të cilat cenojnë imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi të jashtëm.

### 23.2.3. Raportet e ILDKPKI-së

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 13.11.2017, rezulton se ILDKPKI-ja ka arritur në përfundimet se deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin, ka burime financiare të ligjshme

<sup>87</sup> Kryetari i GjASHP Tiranë shprehet se nuk ka ndonjë ankesë pranë kryetarit të Gjykatës nga ndonjë palë në proces apo ndonjë i tretë në lidhje me këta tregues.

<sup>88</sup> Kryetari i GjASHP Tiranë shprehet se nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë problematikë të shfaqur nga ky gjyqtar në lidhje me gjykimet të cilat zhvillohen me trup gjykues të përbërë me 3 gjyqtarë, dhe se shkëmbimi i njohurive apo i përvojës profesionale ndërmjet magjistratit dhe trupës tjetër gjyqësore është tërësisht korrekt dhe i vazhdueshëm.

për të justifikuar pasuritë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaram të rremë dhe se subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

**23.3.** Paanësia e magjistratit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave

**23.3.1.** Përdorimi i gjuhës diskriminuese

- Nga vendimet dhe çështjet e vëzhguara dhe shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjAShP Tiranë, nuk vërehet përdorimi i gjuhës diskriminuese.

**23.3.2.** Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjAShP Tiranë, rezulton se nga 6 kërkesa për përjashtim të paraqitura ndaj gjyqtarit në periudhën e rivlerësimit, 4 kërkesa janë rrëzuar, 1 është pushuar dhe 1 është pranuar.

**23.3.3.** Tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi

- Nga shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjAShP Tiranë, rezulton se në vitin 2014 janë paraqitur prej tij 9 dorëheqje, nga të cilat janë pranuar 8 dhe nuk është pranuar 1; në vitin 2015 janë dhënë 13 dorëheqje, të cilat janë pranuar; dhe deri në muajin tetor 2016 janë dhënë 11 dorëheqje, nga të cilat janë pranuar 8 dhe, me vendim të kryetarit, është pranuar dorëheqja e gjyqtarit dhe çështjet u kanë kaluar gjyqtarëve të cilët kanë vendosur pushimin ose kthimin e padisë, sipas rastit.

**Për sa më sipër, pas vlerësimit të treguesve respektivë, në bazë të të dhënave të nxjerra nga burimet e vlerësimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit përmbush kriterin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave gjyqësore, pasi:**

**a)** Në drejtim të etikës në punë:

i) nga verifikimi i ankesave të paraqitura, nuk rezultojnë të dhëna të tilla që cenojnë etikën në punë në drejtim të tërësisë së normave të sjelljes dhe përdorimit të shprehjeve të pahijshme e ofenduese;

ii) nga mendimi i kryetarit, ku ushtron detyrën aktualisht, nuk rezultojnë të dhëna të tilla që cenojnë etikën në punë, përkundrazi ai vlerësohet pozitivisht;

iii) nuk rezulton që jenë marrë vendime përfundimtare për masa disiplinore.

**b)** Në drejtim të integritetit të magjistratit ndaj çdo ndikimi të jashtëm:

i) nga verifikimi i ankesave të paraqitura, nuk rezultojnë të dhëna të tilla që cenojnë etikën në punë në drejtim të tërësisë së normave të sjelljes dhe përdorimit të shprehjeve të pahijshme e ofenduese;

ii) nuk rezulton që jenë marrë vendime përfundimtare për masa disiplinore;

iii) nga raporti i ILDKPKI-së, nuk rezultojnë të dhëna të tilla që të cenojnë integritetin e magjistratit, përkundrazi ka rezultuar se deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaram të rremë, dhe se subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

c) Në drejtim të paanësisë së magjistratit në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave:

i) nga aktet e vëzhguara, nuk rezulton përdorimi i gjuhës diskriminuese;

ii) nuk rezulton numër tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magjistratit (vetëm 1 nga 6 kërkesa të paraqitura);

iii) rezulton nga tregues të tjerë se në rastet e papajtueshmërisë për të gjykuar çështje të caktuara, të cilat edhe gjyqtari i ka çmuar si të tilla, dhe ka qenë në dijeni, ai ka vënë në lëvizje gjykatën dhe ka respektuar rregullisht procedurën e dorëheqjes.

## 24. Cilësitë personale dhe angazhimi profesional

### 24.1. Aftësitë e komunikimit të magjistratit

#### 24.1.1. Komunikim i qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjAShP Tiranë, rezulton se nuk ka ndonjë ankesë pranë kryetarit të GjAShP Tiranë nga ndonjë palë në proces apo nga ndonjë i tretë në lidhje me këta tregues dhe, sipas kryetarit të GjAShP Tiranë, ai paraqet një gjuhë të qartë komunikimi dhe është transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët.

#### 24.1.2. Respektimi i konfidencialitetit

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjAShP Tiranë, rezulton se ai paraqet një gjuhë të qartë komunikimi dhe është transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit.

#### 24.1.3. Respektimi i parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjAShP Tiranë, rezulton se ai paraqet një gjuhë të qartë komunikimi dhe është transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të mbrojtjes së të dhënave personale.

## 24.2. Aftësia për të bashkëpunuar me kolegët

### 24.2.1. Komunikimi dhe bashkëveprimi me kolegët apo administratën gjyqësore

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjAShP Tiranë, rezulton se nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë problematikë të shfaqur nga ky gjyqtar, në lidhje me gjykime të cilat zhvillohen me trup gjykues të përbërë me 3 gjyqtarë, dhe se shkëmbimi i njohurive apo i përvojës profesionale ndërmjet magjistratit dhe trupës tjetër gjyqësore është tërësisht korrekt dhe i vazhdueshëm.

### 24.2.2. Shkëmbimi i njohurive apo i përvojës profesionale

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.10.2016, e Shkollës së Magjistraturës, rezulton se z. Gentian Medja ka qenë moderator në *Programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës*, në aktivitetin trajnues *Trajtimi me temë "Falimentimi"*, të zhvilluar më datë 16.10.2013.

## 24.3. Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera

### 24.3.1. Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.10.2016, e Shkollës së Magjistraturës dhe shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e Shkollës së Magjistraturës, rezulton se z. Gentian Medja për vitet 2013-2016 ka qenë pjesëmarrës në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

- Tema: *Tryezë diskutimi me lehtësuesit e Programit të trajnimit vazhdues, cilësia e përgatitjes, materialet e seminareve, jurisprudencë dhe aspekte të tjera formale të përmbajtjes*, datë 06.02.2013.
- Tema: *Evoluimi i teknikave të prezantimit të çështjes dhe provave në Shqipëri*, datë 21.03.2013.
- Tema: *Zbatimi i sistemit të drejtësisë administrative në Shqipëri*, datë 21.11.2013.
- Tema: *Koncesionet*, datë 05.12.2013.
- Tema: *Gjykimi administrativ sipas ligjit të ri nr. 49/2012*, datë 23.12.2013.
- Tema: *Faza e ekzekutimit të procesit gjyqësor administrativ, sipas ligjit të ri nr. 49/2012*, datë 24.12.2013.
- Tema: *Prokurimi publik dhe praktika gjyqësore*, datë 22 - 23.04.2014.
- Tema: *E drejta administrative*, datë 02.04.2014.

- Tema: *Legjislacioni tatimor dhe prokurimi publik*, datë 14.11.2014.
- Tema: *Problematika që përcillet në gjyqësorin shqiptar në lidhje me legjislacionin në fushën e tatimeve, aspektet ligjore, aspektet praktike, jurisprudencë e GjL-së*, datë 30.01.2015.
- Tema: *Ndihma juridike në fushën civile dhe administrative, roli i Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike, në zbatim të ligjit nr. 10039/2008*, datë 10.02.2015.
- Tema: *Problematika që përcillet në gjyqësorin shqiptar në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fushën e doganave*, datë 23.02.2015.
- Tema: *Kontrata administrative e civile dhe shqyrtimi i tyre në arbitrazhin ndërkombëtar dhe vendas, zgjidhja e konflikteve përmes arbitrazhit, ankimi i vendimeve të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit*, datë 12.03.2015.
- Tema: *Drejtësia administrative*, datë 29-30.06.2015.
- Tema: *Rregullimi ligjor i marrëdhënieve të punës dhe problemet që ndeshen në praktikën gjyqësore, në kuadër të zbatimit të dispozitave të Kodit të Punës dhe ligjit nr. 49/2012, si dhe ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civilë”, përfundimin e marrëdhënies së punës sipas Kodit të Punës dhe lirimi nga shërbimi civil, transferimi sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit të shërbimit civil, transferimi i përkohshëm dhe i përhershëm, dallimi mes gjykimit administrativ dhe atij civil në aspektin e zbatimit të rregullave procedurale të parashikuara në ligjin nr. 49/2012 dhe K.Pr.C., roli i gjykatës civile dhe administrative në këto gjykime dhe trajtimi i problemeve që shfaqen aktualisht*, datë 09-10.07.2015.
- Tema: *Kodi Administrativ (ToT)*, datë 09.09.2015.
- Tema: *Kodi Administrativ*, datë 10.09.2015.
- Tema: *Asistencë për mbrojtjen më të mirë në lidhje me nenin 10, liria e shprehjes, të KEDNJ, përmes zbatimit të standardeve të GjEDNJ*, datë 20-21.10.2015.
- Tema: *Zhvillime të legjislacionit fiskal në këndvështrimin e gjykimeve administrative*, datë 25.11.2015.
- Tema: *Ligji evropian, konkurrenca*, datë 17-18.12.2015.
- Tema: *Insitute të së drejtës procedurale administrative sipas Kodit të ri të Procedurave Administrative*, datë 11.04.2016.
- Tema: *Shërbimi civil dhe praktika gjyqësore, marrëdhëniet e punës në administratën publike, analizë e instituteve të parashikuara nga ligji për shërbimin civil, disiplina në shërbimin civil dhe masat disiplinore, problematika që është evidentuar nga praktika gjyqësore*, datë 16-17.01.2017.

- Tema: *Procedura administrative në vështrim të Kodit të ri, datë 02-03.03.2017.*
- Tema: *Kontrata administrative e prokurimit publik, analizuar edhe në ndryshimin që sjell Kodi i ri i Procedurave Administrative, problematikat e zbatimit të këtyre kontratave dhe procedura e ankimit publik, administrativ dhe gjyqësor, prokurimi publik dhe praktika gjyqësore, datë 03-04.04.2017.*
- Tema: *Ushtrimi i balancimit të rasteve të shpifjes, balancimi i të drejtave të reputacionit dhe liria e shprehjes, datë 23-24.11.2017.*
- Tema: *Trajnim i gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në materialet e programit/platformës HELP për nenin 14 të KEDNj-së, ndalimi i diskriminimit, diskriminimin e komuniteteve me aftësi të kufizuara, diskriminimin e minoriteteve, diskriminimin e romëve, diskriminimin e komunitetit LGBT (njëditor), datë 13-14.12.2017.*
- Tema: *Drejtësia administrative, natyra e gjykimit administrativ dhe pushtetet e gjyqtarit administrativ, çështje të legjitimitetit dhe kompetenca e gjykatave administrative, llojet e padive në gjykimin administrativ, procesi i rregullt ligjor në gjykimin administrativ, datë 17-18.01.2018.*
- Tema: *Rregullat dhe standardet etike për gjyqtarët, sipas kuadrit rregullator në fuqi dhe ndryshimet e pritshme, rregullimi i ri kushtetues në lidhje me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilltari i Etikës etj., shkeljet disiplinore sipas ligjit nr. 96/2016, standardet e etikës profesionale gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, rregullime që duhet të gjejnë vend në Kodin e Etikës dhe efikasiteti i mekanizmit zbatues (të dhëna bazë mbi procedurën dhe kriteret, si dhe përqasja me standardet dhe praktikën e mira evropiane), datë 14-14.02.2018.*
- Tema: *Çështje të Kodit të Procedurave Administrative në drejtim të pavlefshmërisë dhe paligjshmërisë së akteve administrative, anulimit dhe shfuqizimit të akteve administrative dhe pasojave që vijnë prej tyre, të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet shkaqeve të pavlefshmërisë absolute dhe paligjshmërisë, si dhe anulimit e shfuqizimit të akteve administrative, datë 04-05.04.2018.*
- Tema: *Përfaqësja e legjislacionit shqiptar me të drejtën komunitare në fushën e prokurimeve publike, praktika e GjED-së në fushën e prokurimeve publike, praktika e GjED-së me fokus në kontratën administrative, datë 16-17.05.2018.*
- Tema: *Natyra e mjeteve ligjore administrative, natyra e ankimit administrativ, procedura e shqyrtimit nga organi kompetent dhe organi epror, dallimi ndërmjet tyre, objekti i kundërshtimit administrativ si risi në legjislacionin administrativ, rishikimi - një mjet i ri ligjor në procesin*

*administrativ, natyra e ankimit administrativ dhe efekt reformation in pejus në procesin administrativ, sipas K.Pr.Administrative, datë 20-21.06.2018.*

- Tema: *Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në Shqipëri, datë 20-21.06.2018.*
- Tema: *Protokolli XVI i KEDNj, datë 20-30.06.2018.*
- Tema: *Çështje të drejtësisë administrative, datë 16-17.01.2019.*
- Tema: *Risitë e Kodit të Procedurave Administrative, datë 18-19.02.2019.*
- Tema: *E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GjEDNj, datë 27-28.02.2019.*
- Tema: *E drejta e ankimit e ndërgjyqësve në mungesë në procesin civil, datë 02-03.05.2019.*

#### **24.3.2. Pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale**

- Nga vërtetimi i datës 24.10.2016 i Shkollës Private të Arsimit të Lartë {\*\*\*}, rezulton se z. Gentian Medja ka ofruar shërbimin e mësimdhënies pranë Shkollës Private të Arsimit të Lartë {\*\*\*}, për vitet 2012 – 2014.

#### **24.3.3. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj**

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit<sup>89</sup> të GjAShP Tiranë, rezulton se ka qenë i disponueshëm për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose trajnimin e magjistratëve të rinj, dhe është angazhuar në trajnimin profesional të kandidatëve për magjistrat.

#### **24.3.4. Pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë**

- Nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e Shkollës së Magjistraturës, rezulton se për vitin akademik 2012-2013, është miratuar në rolin e lehtësuesit në aktivitetin trajnues me temë *Kontrata e sipërmarrjes në fushën e ndërtimeve, dallimi i saj nga kontratat e porosisë, risku i sipërmarrjes dhe format e tij, kalimi i pronësisë për sipërmarrjet në ndërtimin e sendeve të paluajtshme.*

---

<sup>89</sup> Neni 20, paragrafi 2 i ligjit nr. 8136/1996, i shfuqizuar, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, në bazë të rezultateve teorike dhe praktike të stazhit, përcaktonte se: “Me kërkesë të drejtorit të Shkollës, kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë, ku zhvillohet stazhi, caktojnë gjyqtarë ose prokurorë, të cilët, pasi kontrollojnë punën e stazhierit, paraqesin raporte vlerësimi për të”.



#### 24.3.5. Pjesëmarrja në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave<sup>90</sup>

- Nga shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, e kryetarit të GjAShP Tiranë, rezulton se ai paraqet një gjuhë të qartë komunikimi dhe është transparent me publikun, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale.

#### 24.3.6. Publikimet ligjore, akademike

- Rezulton se nuk ka të dhëna për publikime të tilla.

**Për sa më sipër, pas vlerësimit të treguesve respektivë, në bazë të të dhënave të nxjerra nga burimet e vlerësimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit përmbush kriterin e cilësive personale dhe të angazhimit profesional, pasi:**

##### a) Në drejtim të aftësisë së komunikimit të magjistratit:

- i) ka rezultuar se nuk ka ndonjë ankesë pranë kryetarit të GjAShP Tiranë nga ndonjë palë në proces apo i tretë dhe paraqet një gjuhë të qartë komunikimi dhe është transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët dhe, si pasojë, ka komunikim të qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët;
- ii) ka rezultuar se në veprimtarinë e gjyqtarit, ai ka respektuar parimin e konfidencialitetit;
- iii) ka rezultuar se në veprimtarinë e gjyqtarit, ai ka respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

##### b) Në drejtim të aftësisë për të bashkëpunuar me kolegët:

- i) ka rezultuar se nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë problematikë të shfaqur në lidhje me gjykimet të cilat zhvillohen me trupa gjykuese të përbëra me 3 gjyqtarë, dhe se shkëmbimi i njohurive apo i përvojës profesionale ndërmjet magjistratit dhe trupës tjetër gjyqësore është tërësisht korrekt dhe i vazhdueshëm dhe, si pasojë, është në përputhje me treguesin e komunikimit dhe bashkëveprimit me kolegët apo administratën gjyqësore;

---

<sup>90</sup> Pikat 2.1, 2.10 dhe 3.4 të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. {\*\*\*}, datë 30.09.2010, “Për miratimin e rregullores për marrëdhënien me publikun, dhe që kanë lidhje me funksionet e ushtruara prej gjyqtarit”, përcaktonte sa në vijim: “1.2. ZMP-ja kryen këto detyra: [...] d) Përgatit deklaratat për shtyp për çdo çështje që çmohet nga kryetari dhe nga gjyqtarët se duhet bërë publike.” [...] 2.1. Për çdo seancë gjyqësore ose pas çdo procesi gjyqësor, trupi gjykues ose gjyqtari i vetëm i çështjes ka të drejtë të vendosë për të informuar publikun në mënyrë të përmbledhur mbi ecurinë e çështjes nëpërmjet një deklaratë për shtyp. Gjyqtari ose trupi gjykues nuk mund të detyrohen ta bëjnë një gjë të tillë. [...] 2.4. Kur vendoset që të hartohet një deklaratë për shtyp, tekstin e harton gjyqtari që kryeson trupin gjykues me ndihmën profesionale të ZMP-së. [...] 2.10. Deklarata mund të bëhet në emër të mbledhjes së gjyqtarëve ose të gjykatës, por asnjëherë në emër të gjyqtarit. Përgjatimisht, deklarata mund të bëhet në emër të gjyqtarit kur ka një interes publik për të dhëna që lidhen me gjyqtarin dhe gjithmonë me konsensusin e tij. Në çdo rast, nuk lejohet bërja publike nga ana e gjykatës e asnjë të dhëne që lidhet me procesin gjyqësor të papërfunduar. [...] 3.4. Kur nuk ka formularë, ZMP-ja është e detyruar të pranojë dhe administrojë kërkesën sipas formës së paraqitur nga kërkuesi. Në këtë rast, ZMP-ja sigurohet që të saktësojë qartësisht se çfarë kërkohet dhe nëpërmjet një memoje shoqëruese, ia paraqet kryetarit ose gjyqtarit për trajtim”.

ii) ka rezultuar se ka qenë moderator në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me kolegët.

c) Në drejtim të gatishmërisë për t'u angazhuar në veprimtari të tjera:

i) ka rezultuar ka në mënyrë të vazhdueshme dhe me tematika të larmishme, ka marrë pjesë në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës;

ii) ka rezultuar se ka marrë pjesë edhe në mësimdhënie, përtej trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës, si tregues i angazhimeve të tjera profesionale;

iii) ka rezultuar se ka qenë i disponueshëm për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose trajnimin e magjistratëve të rinj, dhe është angazhuar në trajnimin profesional të kandidatëve për magjistrat dhe, si pasojë, në përputhje me treguesin e disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj;

iv) ka rezultuar se për vitin akademik 2012–2013, në Shkollën e Magjistraturës, është miratuar në rolin e lehtësuesit në aktivitet trajnues dhe, si pasojë, është në përputhje me pjesëmarrjen e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë;

v) ka rezultuar se paraqet një gjuhë të qartë komunikimi dhe është transparent me publikun, në përputhje me treguesin e pjesëmarrjes në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave;

vi) për publikimet ligjore, akademike s'ka të dhëna.

25. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson që, në vijim të shkaqeve ankimore, të marrë në shqyrtim edhe çështjet e prezantuara nga Komisioneri Publik, dhe që kryesisht janë të lidhura me kriteret e aftësive për të gjykuar dhe ato organizative të subjektit të rivlerësimit.

25.1. Për sa i përket raportit midis zbatimit të standardeve të gjykimit, të miratuara me vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-së, dhe zbatimit të përcaktimeve ligjore përkatëse, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se përparësi ka zbatimi i ligjit organik, në bazë të të cilit ushtron funksionin magjistrati. Subjekt rivlerësimi, në rastin konkret, rezulton të jetë gjyqtari i një gjykate administrative të shkallës së parë, dhe i zbatueshëm për këtë subjekt rivlerësimi është ligji organik nr. 49/2019. Ligji organik nr. 49/2012, në nenin 3, si parim të përgjithshëm sanksionon gjykimin brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, por pa sanksionuar afat maksimal për gjykimin e çështjeve. Nga ana tjetër, ligji nr. 49/2012, përcakton afate për veprimet përgatitore (neni 25), seancën gjyqësore (neni 27), por nuk përjashton mundësinë e zgjatjes së këtyre afateve, veçanërisht kur ato kanë qenë për shkaqe të përligjura. Trupi gjykues nuk ka konstatuar se zgjatja e afateve ka qenë për faj apo neglizhencë të subjektit të rivlerësimit, por ka ndodhur për shkaqe të përligjura, sikurse pamundësia objektive e subjektit të rivlerësimit, kryesisht për shkak të zënies së të gjithë kohës fizike me procese gjyqësore, që e kanë çuar atë në pamundësi fizike kohore.

**25.2.** Për sa i përket zbatimit të bazës ligjore të caktuar nga vetë paditësi, bazuar në të drejtën e tij ekskluzive të disponimit të padisë, në raport me ligjin e posaçëm që zbaton gjykata për zgjidhjen e çështjes, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, në pjesën hyrëse të vendimit, ka të përcaktuar bazën ligjore të kërkesëpadive përkatëse, të paraqitura për shqyrtim para gjykatës administrative dhe, për këtë arsye, ai ka respektuar parimin e disponibilitetit të padisë, ndërkohë që, për sa i përket pjesës arsyetuese dhe asaj urdhëruese, subjekti i rivlerësimit ka realizuar funksionin gjyqësor, duke përcaktuar drejt ligjin e zbatueshëm, që nuk ka qenë domosdoshmërisht ai i përcaktuar nga paditësi në padi. Kjo veprimtari e gjyqtarit konsiderohet si një rrethanë që lidhet me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, e cila nuk mund të zëvendësohet nga institucionet e rivlerësimit, sipas përcaktimit të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

**25.3.** Për sa i përket mungesës së akteve formale për nxjerrjen e urdhrave të brendshëm dhe marrjen e vendimeve të ndërmjetme, për të cilat ligji nuk parashikon të drejtën e ankimit të veçantë, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka dokumentuar në procesverbalet e seancave të zhvilluara, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ligji procedural nuk parashikon shprehimisht që këto akte të dokumentohen në një akt të veçantë. Neni 115 i K.Pr.Civile përcakton se aktet procedurale, për të cilat ligji nuk kërkon forma të caktuara, mund të kryhen në formën më të dobishme për arritjen e qëllimit të tyre. Trupi gjykues i Kolegjit arrin në këtë përfundim, duke iu referuar gjithashtu konceptit të *formalizmit të tepruar*, të trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nga ku është arsyetuar se, në zbatimin e rregullave procedurale, gjykatat duhet të evitojnë njëkohësisht formalizmin e tepruar që do të ndikonte në rregullshmërinë e procedurës, por edhe fleksibilitetin e tepruar me interes të vogël procedural (shih *H.T. etj. kundër {\*\*\*}*).

## 26. Denoncime

**26.1.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se për subjektin e rivlerësimit, sipas rastit, në Komision apo në Kolegj, janë paraqitur denoncime, përkatësisht: nga: i) z. Zh.C. në datën 19.02.2018; ii) nga z. R.B. në datën 07.03.2018; iii) nga z. V.D., në datën 18.05.2018; iv) nga z. G.B., në datën 08.06.2018; v) nga z. Sh.B., në datën 12.06.2018; vi) nga z. R.D., në datën 08.08.2018; vii) nga znj. M.S., në datën 01.03.2019; viii) nga znj. O.K., në datën 17.06.2019 dhe në datën 18.06.2019; si dhe ix) nga z. Sh.M., në datën 22.07.2019.

**26.1.1.** Pasi u verifikuan nominalisht denoncimet e paraqitura, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se ato nuk paraqisnin indicie, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me rrethanat e çështjen konkrete, në drejtim të vlerësimit të kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të nenit 49, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vëren gjithashtu se denoncimet janë paraqitur edhe për çështje që janë në shqyrtim dhe se në përmbajtje pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni apo Kolegji, sipas përcaktimit të nenit E, pika 2, fjalia e fundit

e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016. Në kushtet e mësipërme, denoncimet nuk iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor.

Trupi gjykues i Kolegjit çmon të nevojshme që, nëpërmjet arsytimit të plotë të vendimit që lidhet me këtë çështje, të japë edhe orientimet e tij në lidhje me kryerjen e procesit të rivlerësimit, për sa i përket kriterit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se me qëllimin për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni, kur është e mundur dhe e nevojshme, duhet të administrojë të gjitha burimet dhe të vlerësojë të gjitha kriteret, bazuar në treguesit e përcaktuar në nenet 71, 72, 74, 75, 76 të ligjit nr. 96/2016, dhe njëkohësisht duhet të tregojë mënyrën se si janë administruar burimet dhe janë vlerësuar kriteret, bazuar në treguesit përkatës në analogji me vlerësimin e aftësive profesionale të realizuar për subjektin e rivlerësimit Gentian Medja, sipas arsytimit të mësipërm. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

27. Në përmbyllje, trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit:
  - a) ka aftësi për të gjykuar;
  - b) ka aftësi të pranueshme organizative, të cilat nuk kanë rezultuar në mosrespektim të të drejtave të palëve apo mungesë jo të pranueshme efience ose efektiviteti;
  - c) e ka zhvilluar veprimtarinë gjyqësore në përputhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore; dhe
  - ç) ka demonstruar cilësi personale dhe angazhim profesional, në përputhje me standardet e parashikuara në ligj.
28. Për këto arsye dhe për sa janë detajuar më sipër, sipas përcaktimit të nenit 44, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit konsiderohet “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.
29. Në përfundim të gjithë sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, pasi morri në shqyrtim metodologjinë e propozuar nga Komisioneri Publik, shqyrtoi vendimin nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në burimet, kriteret dhe treguesit që janë përdorur në këtë metodologji, arriti në përfundimin se vendimi i Komisionit është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me shumicë votash, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Medja.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 13.09.2019.

#### **ANËTAR**

**Ardian Hajdari**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **RELATOR**

**Luan DACI**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi - kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, kam mbajtur qëndrim kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për çështjen (JR) me nr. 29, datë 05.11.2018, me ankim të Komisionerit Publik (në vijim “Komisioneri”) kundër vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Medja.
2. Procesi i rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, kryhet mbi bazën e tri kriterëve, atij të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Referuar tri kriterëve bazë, *vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale*, veçmas ka një rëndësi të veçantë dhe po aq të rëndësishëm sa dy kriteret e tjera, që nuk duhet nënvlerësuar.

Përgjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje në Kolegj, objekt shqyrtimi, krahas ankimit të Komisionerit, ishte dhe kundërankimi i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, i pranuar me vendim të ndërmjetëm nga Kolegji.

5. Referuar parashikimeve kushtetuese lidhur me këtë kriter rivlerësimi, qëllimi kryesor është identifikimi i subjekteve të cilët:
  - nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre;
  - kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.
6. Lidhur me subjektin e rivlerësimit Gentian Medja, pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga shumica e trupit gjykues dhe qëndrimit të mbajtur nga Komisioneri në seancë publike, i cili kërkoi në fund lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 01.08.2018, të Komisionit, bazuar në treguesit që kanë rezultuar nga provat e faktet e administruara në Komision dhe në Kolegj, duke pasur parasysh parimin e mbrojtjes së interesit publik, kam krijuar bindjen se vendimi i Komisionit duhet ndryshuar dhe duhet vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Gentian Medja.
7. Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.
8. Referuar kreut VI të ligjit nr. 84/2016 mbi “Vlerësimin e aftësive profesionale”, përkatësisht nenit 43 të tij, mbi procedurat e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, është përcaktuar saktësisht se procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa ky i fundit është i zbatueshëm. Ndërkohë në këtë nen, është përcaktuar se organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale rishikon dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi. Organi, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Ky raport i paraqitet Komisionit menjëherë, por jo më vonë se 90 ditë nga dita e depozitimit të formularit të vetëvlerësimit profesional.

9. Referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në gjykim, duhet të kemi parasysh:
- ✓ aftësinë profesionale të gjyqtarit;
  - ✓ aftësitë organizative të tij;
  - ✓ etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe aftësinë personale dhe angazhimin profesional.
10. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, u është referuar raporteve të përcjella nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, 5 (pesë) dosjeve të përzgjedhura me short, tri vendimeve të përzgjedhura nga subjekti dhe, më pas, 5 (pesë) dosjeve të tjera të përzgjedhura nga vetë Komisioni, *si burime të vlerësimit*.
11. Në shqyrtimin e çështjes në Kolegj, rezulton qartë se nga subjekti i rivlerësimit përgjatë shqyrtimit të këtyre çështjeve ka pasur mangësi të dukshme, siç janë:
1. referenca të gabuara të bazës ligjore në vendim;
  2. mosrespektim *në mënyrë të përsëritur* të afateve në gjykimin e çështjeve;
  3. parregullsi të veprimeve përgatitore në përgjithësi, afatet, urdhrat etj.

1.1 Një ndër aftësitë themelore që duhet të ketë gjyqtari në ushtrimin e detyrës së tij, është aftësia profesionale e tij në drejtim të njohurive ligjore. Njohuria ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin.

1.2 Në këtë rast, pretendimin e Komisionerit në ankim e shoh të drejtë, lidhur me mangësinë e subjektit të rivlerësimit në referencat e gabuara të dispozitave ligjore në vendim. Konstatimi i mangësive të referencave ligjore në çdo fazë të gjykimit të çështjes, i mangësive në njoftimin e palëve etj., ndikojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen jo të drejtë të çështjes dhe cenojnë shumë figurën e gjyqtarit.

2.1 Në dosjet dhe vendimet që janë administruar në Komision për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë konstatuar raste *në mënyrë të përsëritur* të mosrespektimit të afateve në gjykim. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit që këto mangësi kanë ardhur si rezultat i ngarkesës në punë, bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

2.2 Ligjvënësi ka përcaktuar afate kohore, pasi ka konsideruar se këto afate janë të arsyeshme për t’u zbatuar nga gjykatat administrative. Nga pikëpamja kushtetuese, mosrespektimi i këtyre afateve kohore të përcaktuara në ligj, si p.sh., për caktimin e seancës gjyqësore, për shtyrje të seancës, për njoftim të palëve, për zbardhje të vendimit etj., përbëjnë cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

3.1 Në qoftë se u referohemi fakteve që janë konstatuar në Komision dhe në Kolegj, të pretenduara edhe nga Komisioneri në ankimin e tij, kanë rezultuar mangësi të theksuara në mënyrë të përsëritur nga ana e subjektit, në respektimin e afateve të thirrjes së palëve për seancat përgatitore. Në ligjin

nr. 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në nenin 25 të tij, është përcaktuar qartë parimi për një proces të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, duke eliminuar seancat joproduktive. Në paragrafin 22 e në vijim të vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, vërehen qartë mangësitë e subjektit të rivlerësimit.

12. Në qoftë se u referohemi të gjitha burimeve që kanë shërbyer për rivlerësimin e aftësisë profesionale për subjektin, rezulton që subjekti në fillimet e tij mund të ketë filluar mirë veprimtarinë e tij si magjistrat, *por referuar burimeve të vlerësimit të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, rezulton që subjekti i rivlerësimit Gentian Medja ka mangësi të dukshme dhe të përsëritura në afatet për gjykimin e çështjeve, referencë ligjore të gabuar dhe shumë parregullsi në veprimet përgatitore, të cilat cenojnë haptazi zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe cenojnë shumë figurën e magjistratit.*
13. Për të gjitha arsyet e mësipërme, kam mbajtur qëndrim kundër shumicës së trupit gjykues, duke vlerësuar se vendimi nr. 60, datë 01.08.2018, i Komisionit, duhet të ndryshohet.

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*